



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 73 datë 31-07 2025

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË  
DATËS 26 QERSHOR 2025 DHE 21 KORRIK 2025**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës **29.05.2025** në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

**V E N D O S I**

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës **26.06.2025 dhe 21.07.2025** bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Eva NAÇI**

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 31-07-2025

**K R Y E T A R E**

**Ana VERUSHI**



## -PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 26 QERSHOR 2025

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 21

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 21

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo dhe drejtorë të administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita të gjithëve, para se të fillojmë me materialet e rendit të ditës, doja të tërhiqja vërejtje gjithë këshilltarëve se ardhja në mbledhjet e këshillit nuk është dëshirore por detyrimore sipas ligjit, nëse dikush ka diçka të lajmërojë dhe mos kemi këtë pritje kot para mbledhjes të këshillit, para se të filloj me rendin e ditës, doja t'ju thoja këshilltarëve se ka erdhur një material shtesë nga shoqëria anonime fruta-perime Korçë, kush është dakort që ky material të futet në rendin e ditës, kush është dakort, ju lutem këshilltarëve të votojnë?

Për futjen e materialit në rendin e ditës të Shoqërisë Anonime Fruta-Perime.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 17

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 4

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 21 këshilltarë, 17 pro, 0 kundër, 4 abstenim.

Këshilltar D.Osmani: Të nderuar kolegë, do ju lutesha meqënëse ne e bëmë si diskutim para se të fillonte mbledhja dhe arsyet pse ai material nuk është futur në kohën e duhur pa çka se dhe si material ka një kapacitetet i cili duhet vlerësuar nga këshilltarët nga të gjithë ne dhe duhet analizuar, kishte nevojë për me shumë kohë, gjithsesi për të shmangur ato penalitetet dhe afatet që mos penalizohet, ne nuk jemi këtu për të penalizuar njerëzit që punojnë, do ju lutesha që herës tjetër drejtuesit e institucionit të kenë kujdes t'i fusin në kohë dhe ne të jemi të njohur me materialet, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, i bashklohem mendimit tuaj, ky material do futet si pika e 12 e rendit të ditës.

Këshilltar K.Pllaha: Diçka për rendin e ditës, përshëndetje të gjithëve njëherë meqëse kemi për të diskutuar buxhetin afatmesëm mund të kemi ndërkohë që trajtojmë pikat e tjera dhe raportin e rekomandimeve të Ministrisë të Financave për këtë fazë, sepse nuk e kishim në materialet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Bona, të lutem.

Drejtoria e Financës V.Ziko: E presim të vijë materiali.

Këshilltar K.Pllaha: E presim të vijë gjatë mbledhjes?

Drejtoria e Financës V.Ziko: Jo gjatë mbledhjes, nuk e kam marrë akoma materialin.

Këshilltar K.Pllaha: Nuk ka erdhur nga ministria, domethënë po e kalojmë pa marrë rekomandimet.

Drejtoria e Financës V.Ziko: Nuk ka ndonjë gjë kjo, mund ta reflektojmë mbledhjen e ardhshme.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëherë, kush eshë dakort me rendin e ditës bashkë me pikën 12.

**Pika 1 e rendit të ditës.**

**PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.**

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 21 këshilltarë, 21 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Vazhdojmë me pikën e dytë.

**Pika 2 e rendit të ditës.**

**PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 26 QERSHOR 2025.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 21 këshilltarë, 21 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

**Pika 3 e rendit të ditës.**

**“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 MAJ 2025”.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem të shprehet.

Këshilltare E.Mitre: Faleminderit znj.kryetare, përshëndetje të gjithëve, për muajin maj janë 47 familje përfituese nga 6 % e fondit të kushtëzuar fond i cili është shtuar çeljes faktike nga lista e përfituesve të



ndihmës ekonomike të përzgjedhur nga sistemi, kështu që kemi në dispozicion fondin e 231 mijë e 600 lekë si 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike nga sistemi i pikëzimit që nga ky fond përfitojnë 47 familje të përzgjedhura 148 mijë e 908 lekë, gjithashtu kompensim të energjisë elektrike përfitojnë 21 familje në shumën 26 mijë e 400 lekë, ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor 17 familje 61 mijë e 62 lekë, tableta i kanë specifikuar të gjithë përfituesit, keni e një tabelë të veçantë kësaj rradhë me emrat e 7 personave të cilat dalin nga skema për shkaqe që i keni të paraqitura në tabelë, ju ftoj ta miratoni materialin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 21 këshilltarë, 21 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

**Pika 4 e rendit të ditës.**

**MBI NDRYSHIMIN E NIVELIT TË QIRASË PËR VITIN 2025 NË BANESAT ME QIRA SOCIALE.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem edhe njëherë.

Këshilltare E.Mitre: Referuar ligjit nr.139 të vitit 2015 për vetëqeverisjen vendore dhe ligjit nr.22 të vitit 2018 për strehimin social i ndryshuar, kemi materialin para nesh, Bashkia Korçë ka në pronësi të saj 98 banesa sociale të cilat janë ndërtuar deri në vitin 2013 me fonde të veta, në bashkëfinancim me buxhetin e shtetit, fonde nëpërmjet kredisë me Bankën e Këshillit të Europës, për fondin publik të banesave sociale me qira të bashkisë Korçë është llogaritur niveli i ri i qirasë sociale për vitin 2025 i cili është referuar të dhënave të Isatit mbi indeksin e çmimit të konsumit për vitin 2024 është 2.2% , në tabelë janë detajuar të gjitha ndryshimet e mundshme që mund të bëhen, niveli i ri i qirasë mbas indeksimit do përdoret deri në fund të muajit janar të vitit pasardhës dhe efektet financiare nisin prej shkurt 2025, ftoj këshillin ta miratojë këtë material.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar K.Pllaha: Kisha disa pyetje, e para a zbatohet e njëjta masë indeksimi dhe për të gjitha format e tjera të përkrahjes sociale që oforn bashkia, fondin 6% apo gjithë format e tjera, jo ato që jep jo ato që merr nga qytetarët?

Pyetja e dytë, që lidhet me banesat me qira sociale, në cilat forma një person që ka përfthuar një banesë me qira sociale mund ta humbasë atë?

E treta në diskutim me banorët që jetojnë atje, ata kanë një pritshmëri të caktuar që këto banesa mund të privatizohen, doja një përgjigje nga kryetari i bashkisë, a ka ndonjë formë sesi mund të privatizohen nga banorët aktualë apo është e pamundur?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të flas apo mos ka ndonjë pyetje tjetër?

Këshilltar L.Petri: Faleminderit znj.kryetare, doja të dija nëse është në vizionin dhe objektivin e ekzekutivit që në të ardhmen e afërt të bashkëpunohet me private që janë ndërtues dhe nuk e di sesi mund të gjendet një formulë bashkëpunimi dhe të ketë një integrim që janë ndërtues dhe nuk e di sesi mund të gjendet një formulë bashkëpunimi dhe të ketë një integrim të banorëve të cilët kërkojnë strehim social dhe banorëve të cilët janë jashtë kësaj kategorie.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pyetje cila është?

Këshilltar L.Petri: Kjo është pyetja, fjala vjen nëse unë jam një ndërtues dhe më ofrohet një leje ndërtimi sipas ligjeve që janë në fuqi dhe të negociohet me Bashkinë Korçë mund të ndërtohet nga 6 kate në 8 dhe dy nga këto të shfrytëzohen për këtë qëllim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka pyetje të tjera, fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Përsa i takon materialit që kemi sjellë, ky indeksimi i çmimit të qirasë është një detyrim ligjor që ne e kemi në bazë të ligjit dhe është specifikuar dhe në kontratën e qirasë që secili prej përfituesve ka me Bashkinë e Korçës, pra është një proces sepse e kemi bërë dhe disa herë debat me banorët dhe jam përpjekur t'ja u shpjegoj dhe besoj se në ndërgjegjie më kuptojnë por mbase askujt nuk i vjen mirë kur kanë ndryshime në rritje qofshin këto edhe të vogla, është e specifikuar në bazën e rritjes, bazë të cilën ata e kanë përfituar këtë banesë dhe është e specifikuar në kontratë ku çdo vit ne duhet të bëjmë indeksimin e çmimit sipas normës të inflacionit. Tani përsa i takon indeksimit të pagesave që kategoritë në nevojë marrin nga qeveria, një shpjegim konkret mund të japë mbase Marjana kësaj pike por ajo që duhet të them unë në pozicionin e kryetarit të bashkisë është që për gjithë këto pagesa të ndihmës ekonomike apo pagesave të tjera që marrin nga shteti ne si bashki jemi në pozicionin e institucionit që përgatit listat dhe bën shpërndarjen pra nuk është se kemi vendimmarrje ne për përfitimin financiar që ata duhet të marrin, megjithatë në rast se ky indeksim bëhet apo jo, ta shpjegojë pak Marjana, përsa i takon pyetjes se kur këta përfituesit e banesave me qira sociale dalin jashtë, kur është e detyruar bashkia që të fillojë procedurën për ti larguar nga këto banesa, për këto mund të përgjigjet Mirela për privatizimin e banesave po është e specifikuar në një prej dokumentave të praktikës bazuar në të cilën këta e kanë përfituar këtë banesë që nuk mund të bëhet privatizimi i këtyre banesave pa kaluar afatin 10 vjeçar, jo që privatëzimi do të bëhet kur të kalojë afati 10-vjeçar pra janë dy



gjëra të ndryshme por gjithsesi kjo i hap mundësinë teorikisht fillimit të një praktike për privatizim në kemi bërë disa herë komunikim shkresor me drejtorinë përkatëse të strehimit social, tani ndodhet tek Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për këtë kërkesë të banorëve dhe në momentin që do ketë një reagim për të plotësuar bazën ligjore për të vazhduar këtë procedurë të privatizimit në do jemi të gatshëm të angazhohemi si bashki për çfarë detyrime kemi, pra nuk është një procedurë që e bëjmë apo e përcaktojmë ne si kuadër ligjor, hapësira ligjore ekziston kërkesën e kemi bërë jemi në pritje. Përsa i takon përfshirjes të privatëve ndërtues në skemat e strehimit social ju mbase e dini që ka një ligj për strehimin social i cili përcakton të gjitha mënyrat që shteti kontribon për të zbutur problematikën e strehimit social dhe atje keni që nga banesat me kosto të ulët që nga bonusi i strehimit, që nga banesat me qira sociale, që nga pajisja e truallit me infrastrukturë për tu përdorur më pas për qëllime të strehimit social dhe gjithashtu kuadri ligjor është plotësuar dhe me detyrimin vitet e fundit se çfarë janë ndërtime me sipërfaqe më të madhe se 2000 M2 për qëllime banimi, pra rezidenciale janë të detyruar që 3% të këtij fondi ta vënë në dispozicion të strehimit social dhe kjo masë është duke u zbatuar edhe nga bashkia e Korçës, të gjithë atyre ndërtuesve që ndërtojnë sipërfaqe më të madhe se 2000M2 ju kemi kërkuar të bëjnë sipas kuadrit ligjor të bëjnë marrëveshje për këtë angazhim dhe pastaj në momentin e marrjes të çertifikatës të përdorimit të bëjnë dhe likudimin që përcakton ligji ose në vlerë monetare, ose në sipërfaqe banimi. Këto janë format që përcakton ligji për të mbështetur problematikën e strehimit social. Tani si dalin jashtë Mirela dhe si bëhet indeksimi i ndihmës ekonomike sipas inflacionit Marjana.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për drejtoreshën e shërbimit social.

Drejtorja e Shërbimit Social M.Jorgji: Indeksimi në fakt detyrimin e ka Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e cila për çdo kategori e bën njëherë në vit si për ndihmën ekonomike ashtu edhe për personat me aftësi të kufizuar, për ndihmën e ekonomike bëhet direkt nga sistemi elektronik sepse ndihma ekonomike nuk funksionin si pagesa e personave me aftësi të kufizuar por ka system elektronik, kështu që kjo bëhet nga Ministria njëherë në vit.

Drejtorja e Strehimit social M.Balli: Në lidhje me pyetjen kur mund ta humbasë banesën sociale një nga familjet që është e autorizuar të banojë atje dhe këto janë të përcaktuara në ligj dhe e humbet të drejtën ku çënon një nga kriteret bazë në të cilën ai e ka përfituar, siç është kushti i strehimit, gjatë banesës atje mund të ketë fituar një pronë që është një banesë tjetër, këtë e vërteton me dokumentin e pronësisë, kur nuk panguan qiranë më shumë se tre muaj normalisht njoftohet ose do bëjë pagesën ose do largohet, kur e përdor apartamentin për qëllime të tjera edhe kjo e vërtetuar dhe tjetra kur tejkalon të ardhurat mbi 120% të të ardhurave mesatare të cilat niveli i të ardhurave mesatare është një e dhënë që vjen nga instati si e bën drejtorja e strehimit këtë punë, kontrata e dhënies me qira për banesat sociale pronë e bashkisë Korçë është një dokument që rinovohet njëherë në vit dhe familjarët e kanë detyrim ligjor që rinovimin e kontratës ta bëjnë në momentin që kanë shlyer detyrimet, përfshirë këtu edhe detyrimet për ujë dhe drita pra shërbime komunale dhe vazhdon duke u shoqëruar me dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me



të ardhurat e çdo pjesëtari të familjes dhe dokumentin e vërtetimit negativ pozitiv që del nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës këto dokumenta ne na shërbejnë për të parë nëse jemi në kushtet e strehimit social për këtë program apo jo, nuk e di sa e qartë jam me këto që thashë.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare nga fjala e z.kryetar dhe kolegeve të ekzekutivit unë kam dy konstatime, e para që lidhet me gjuhën që përdoret rrjedhimisht që krijon një pritshmëri tek këto kategori sociale sepse rrjedhimisht duke ju thënë atyre që privatizimi nuk mund të bëhet pa kaluar afati 10-vjeçar ndoshta ata e marrin të mirëqënë që pas 10 vitesh ata do sigurojnë dokumentin e privatizimit mendoj se këtu ka nevojë për vëmendje dhe me të njëjtën mënyrë të menduari dhe ajo që po siguronim në lidhje me bashkëpunimin me ndërtuesit, ligji që e ka që 3% e fondit duhet vënë në dispozicion ky është detyrim ligjor por nuk besoj se do ishim kundër ndonjë konvente ndërkombëtare nëse ne si bashki do kërkonim 5 ose 7, nuk dua të jem taksativ në shifrat por si metodë të parit të gjësë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani unë për atë pikën e parë nuk di si t'ja u them ndryshe banorëve që mos krijojnë pritshmëri të gabuara, pra ligji e lejon, e krijon si prespektivë thotë se nuk mund të bëhet privatizimi i banesave pa kaluar afati 10-vjeçar, pas 10 vitesh kaq nuk e specifikon më tutje, nuk ka ndonjë gjë sesi bëhet ne si kërkesë e kemi bërë, ja kemi përcjellë ministrisë, drejtorisë përkatëse disa herë që kemi kërkesë nga banorët për tu kryer privatizimi i këtyre objekteve ju lutem na informoni cili është kuadri ligjor, nuk po krijojmë pritshmëri, nuk po themi asgjë më tepër sesa thotë baza ligjore për këtë gjë. Përsa i takon kësaj tjetres patjetër që ka kufizime ligjore, këtu përshembull kemi dikë që ka kompani ndërtimi ose aksioner tek një kompani ndërtimi, do i vinte mirë? Le që nuk e kemi si tagër po të bënim një ndërhyrje arbitrare të theshim këtë 3% do e bëjmë 10%, nuk është minimum 3% është fikse.

Këshilltar L.Petri: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë të jem kundër, unë e inkurajoj shumë këtë gjë nëse do ndodhë, 3% është detyrim ligjor për hir të së vërtetës, unë jam i detyruar të imponoj kufizimin ligjor nga ana tjetër dera jonë si bashki është e hapur për çdo lloj kontributi, doancioni, në natyrë, në lekë për çfarëdolloj funksioni që ne mbulojmë si bashki nga strehimi social dhe deri në funksione të tjera, kushdo i lutur ai që nuk e di le ta dëgjojë nuk them asnjë gjë në vlerë leku, në natyrë çfarëdolloj gjëje.

Këshilltar L.Petri: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: ju lutem mos kalojmë t'i qëndrojmë pikës, ju lutem këshilltarëve e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 18

Vota KUNDËR 4

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 18 pro, 4 kundër, 0 abstenim.

(Erdhi këshilltare Ornela Alikaj.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Më vjen keq që këshilltarët përfitojnë nga mungesa e kourumit dhe votojnë kundër pika të cilat mbledhjet e kaluara i kanë votuar pro, e komentoj sepse pashë në votimin e parë si i ngritët duart dhe ka qënë kundër vetëm z.Pllaha.

**Pika 5 e rendit të ditës.**

**MBI NDRYSHIMIN E NIVELIT TË QIRASË PËR VITIN 2025 NË BANESAT ME QIRA SOCIALE.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem edhe njëherë.

Këshilltare E.Mitre: Bëhet fjalë për një instrument tjetër të programit të strehimit, banesa sociale sociale me qira që ndihmon individë dhe familje që për shkak të pamundësisë ekonomike nuk përballojnë pagesën e qirasë të tregut të lirë, sigurimi kryhet në bashkëfinancim me fonde të sigurara nga buxheti i shtetit nëpërmjet Minsitrisë të Kulturës Rinisë dhe Inovacionit referuar aplikimeve të cilat janë bërë nëpërmjet E- Albania dhe për të përfituar nga programet e strehimit social për vitin 2025 rezulton një familje e cila është në përputhje të kushteve dhe ka plotësuar të gjitha kriteret e vëna, qytetari në të cilën ju e keni në material emrin do mbështet me bonus strehimi si familje e mbetur pa strehim për shkak të prishjes të banesës e cila është e palegalizuar dhe ndodhet në sheshin ku Enti Kombëtar i Banesave do ndërtojë banesa me kosto të ulët, masa e subvencionimit të qirasë është e pjesshme 85 5 e vlerës mesatare të qirasë sipas përbërjes familjare, në tabelën bashkangjitur materialit i gjenin të gjitha llogaritë e bëra, ju ftoj ta miratojmë materialin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar D.Osmani: Kisha një pyetje jo me bonusin por me problematikën që ka lindur për tu përfituar ky bonus, qytetari në fjalë i është prishur shtëpia sipas këtij materiali për arsye sepse atje do ndërtohet banesa sociale, ka ndonjë afat, është miratuar ndërtimi i këtyre banesave, nëse është miruar kur është afati që do fillojë ndërtimi, mund të na japi një informacion ekzekutivi?

Drejtorja e Strehimit social M.Balli: Mendojmë se ka një afat të paktën, kështu është programuar që brenda vitit 2028 ne do kemi 40 apartamente të cilat do i ndërtojë Enti Kombëtar në atë shesh.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ideja është se nuk mund të themi një afat të qartë sepse ndërtimi i kësaj banese nuk do bëhet nga bashkia, ideja është se njëlloj si ato banesat e tjera me kosto të ulët në këtë zone, kemi vënë truallin në dispozicion, kemi bërë marrëveshjen dhe objekti do ndërtohet nga Enti Kombëtar i Banesave, jemi në fazën që kemi këto afate nga ana e tyre shpresoj të përmbushen.



Këshilltar D.Osmani: Z.Kryetar arsyeja pse unë ta bëra këtë pyetje është sepse zotërisë në fjalë i është prishur banesa kur nuk ka një afat mbi të cilën ju keni planifikuar të ndërtoni banesat sociale, në një kohë ku shumë mirë kur ta kishit në dorë këtë vendim dhe miratim të këtij fondi atëherë mund tja prishnit zotërisë në fjalë sepse ka ndodhur që së fundmi po shikojmë që investitorët strategjikë ashtu sinë bregdetin e Shqipërisë ja u keni marrë privatëve disa vite më parë pronat e tyre ja u keni shtetëzuar për projekte madhore, infrastrukturore dhe sot qeveria Shqiptare ja u ka dhënë investitori strategjik me miratimin tuaj të bashkisë po të njëjtën prone, kam hall se do ndodhë e njëjta gjë dhe me zotërinë në fjalë apo me të gjithë ne vite më vonë prandaj po e bëj këtë pyetje sepse ti prishësh dikujt shtëpinë pa patur një projekt të miratuar është e thjeshtë e gjen sot mundësinë, e gënjen edhe me kuotën e asaj qiraje, nesër e gënjen me atë se do ta japim atje një hyrje ose një shtëpi edhe në fund fare na rezulton pas disa vitesh që ja jepni ndonjë investitori strategjik.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E bëtë dhe pyetje dhe koment në të njëjtën kohë, fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shumë faleminderit për spekulimin e pastër dhe pastaj për këtë lidhje pa vend të dy pikave që nuk kanë fare lidhje me njëra-tjetrën, atëherë në rastin konkret, bëhet fjalë për zonën e ish-Dëbojës e cila është tërësisht në pronësi të Bashkisë Korçë dhe në të cilën ndodhen struktura të ish repartëve ushtarake të cilat vazhdojnë të banohen në një pjesë të tyre nga familja, kemi qënë shumë të vëmendshëm dhe të kujdesshëm që ndërhyrjet të realizohen vetëm kur të fillojë ndërtimi i godinave të reja, nuk është se i kemi prishur të gjitha sepse po të ishte kjo mënyrë sjellje që ju thatë ne do i kishim prishur këtu e para kur filluan ndërtimi i banesave me kosto të ulët, sepse nisën të ndërtohen banesa me qira sociale, vazhduan të ndërtohen banesa me kosto të ulët dhe tani po ndërtohen dhe prishja po bëhet vetëm në sheshin e ndërtimit që duhet për të ndërtuar objektin erradhës jo për të prishur gjithë strukturat, pavarisht se të gjithë janë informuar që e ardhmja e ndërtimit nuk do jetë atje, ajo është një pronë e Bashkisë që do zhvillohet sipas projekteve të saj për të plotësuar ato nevojat ndaj qytetarit, e kundërta ka qënë shumë e vërtetë kemi qënë shumë të kujdesshëm dhe kemi ndërhyrë kur i thonë kështu me bisturi për pastruar vetëm atë entin për të ndërtuar banesat e tij, biles në raste të caktuara në bashkëpunim me entin kemi bërë edhe spostime të objekteve pak majtas-djathtas që kur është një ndërhyrje që prek vetëm një cep të objektit të shpëtohet ai cepi për pak kohë dhe të prishet vetëm kur ndërhyrja është e qënësishme ky është spekulimi që bërë, kjo lidhja me investitorët strategjikë kjo është një temë më vete mos e perzjejme me të e lemë në të ndryshme, kjo që sapo the besoj nga fjalimi tim e kuptove dhe ata që na ndjekin e kuptuan se ky ishte një spekulim i pastër sepse jo vetëm që nuk kemi qënë të ndjeshëm por kemi qënë më shumë sesa duhet.

Këshilltar D.Osmani: Tani të thuash spekulim për faktin që ju keni prishur shtëpi pa patur një projekt.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani Devi të lutem sepse nuk dua të dal nga vetja.

Këshilltar D.Osmani: Po dil nuk ka ndonjë gjë të madhe të dalësh nga vetja.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem evitoni këto përplasje të pa nevojshme.



Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më dëgjove ndonjëherë të them nuk ka projekt, jo vetëm që ekizston projekti, jo vetëm që jemi dakortësuar por kemi vepruar vetëm në momentin kur enti na ka thënë më lironi sheshin sepse duhet të filloj duhet ta rregjistroj në emrin e entit që të filloj procedurën time të prokurimeve të objektit. Ku e dëgjove ti që unë thashë nuk ka projekt?

Këshilltar D.Osmani: Nuk thatë datë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Datën tani ngaqë nuk kam qejf të gënjej dhe spekulloj ju thashë datën që na ka dhënë enti duke bërë komentin që kjo është data që na ka dhënë enti i banesave që mund të jetë e më shpejt por mund të jetë edhe kjo datë, nuk e di.

Këshilltar D.Osmani: Mirë pra unë nuk spekullova, ndoshta nuk ka dhe datë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit z.kryetar, nëse nuk ka diçka tjetër lidhur me këtë çështje e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 21 këshilltarë, 21 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

**Pika 6 e rendit të ditës.**

**MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË GRANTIN E MENJËHERSHËM NË BANESAT ME KOSTO TË ULËT NGA BUXHETI I SHTETIT.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare E.Mitre: Atëherë materiali i ardhur nga ekzekutivi, përsëri është instrumenti financiar granti i menjëhershëm i cili lehtëson blerjen e banesave për disa familje që i përkasin kategorive të përcaktuara, më poshtë keni familjet që përfitojnë, pasi kryejnë aplikimin online nëpërmjet portalit E-Albania duke paraqitur kërkesat dhe dokumentacionin e nevojshëm atëherë bëhet spallja e fituesve. Pas aplikimit online nëpërmjet këtij portali përfitojnë 4 familje nga granti i menjëhershëm, në listën bashkangjitur këtij materiali ju mund të gjeni 4 familjet, lista e përfituesve e cila hartohet nga zyra përkatëse e njësisë vetëqeverisjes vendore sipas dokumentacionit përkatës vlerësohet nga struktura përgjegjëse e strehimit dhe miratohet nga këshilli i vetëqeverisjes vendore pas miratimit nga Ministria e Ekonomisë të fondit për familjet dhe në zbatim të ligjeve përcaktuese, ju ftoj ta miratojmë edhe këtë material.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje?

Këshilltar K.Pllaha: Përveç familjeve që janë të përcaktuara në material, ka kriter ekonomik apo jo?



Drejtoria e Strehimit Social M.Balli: Kriteret janë të përcaktuara qartë në vendim dhe kanë të bëjnë vetëm me këto kategori, kriter ekonomik nuk ka.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit ,e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 20

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 21 këshilltarë, 20 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

**Pika 7 e rendit të ditës.**

**MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESE 2026-2028, FAZA E PARË.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltari A.Përmeti: Përshëndetje, komisioni u mbledh ditën e hënë në orën 12 dhe trajtoi materialin, në komision ishin të pranishëm 3 anëtarë nga 5, pas diskutimeve dhe paraqitjes që i bëri ekzekutivi projektbuxhetit afat mesëm unë do prek disa pika për pjesën e qytetarëve por edhe këshilltarëve. Projektbuxheti afatmesëm është dokument i rëndësishëm dhe kjo është faza e parë për miratimin e tij, bazuar edhe në ligjin për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, për financat e vetëqeverisjes vendore, udhëzimet gjithashtu për procedurat standarte për përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm, gjithashtu në zbatim të udhëzimit të shkurtit 2025 për përgatitjen e programit buxhetor 2026-2028, Bashkia Korçë ka përgatitur materialin i cili nuk vjen vetëm me pjesën e relacionit por me pjesën e detajimit të secilit program, të 11 programeve dhe gjithë aktivitetëve dhe llogarive që lidhen me secilin program. Programi buxhetor afatmesëm është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar disa vjeçare dhe konkretisht jemi 2026-2028 të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe kjo bëhet për planifikimin sa më të mirë të menaxhimit dhe lëvrimit të shërbimit që janë shpeznimet që kryhen bashkia sipas programeve. Ky dokument është kryesori i planifikimit vendor ku merren parasysh përfaqja e strategjia e zhvillimit të qeverisë Shqiptare, strategjia sektoriale apo strategjitë e vetëqeverisjes vendore dhe këto integrohen në këtë dokument planifikues, gjithashtu ju kujtoj se ne kemi miratuar tavanet buxhetore si për pjesën e të ardhurave dhe kjo jep një dokument të detajuar më tej pasi ne miratuar këto tavane buxhetore. Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë ndihmon në njësitë e vetëqeverisjes vendore të planifikojnë sa më mirë shërbimet publike duke llogartuar në afatmesëm në periudhë 3-vjeçare, këto bazohen në ndryshimet e parashikuara demografike, lidhen me nevojat e banorëve dhe me strategjinë që ka secila qeverisje vendore. Në material është e parashikuar më vete pjesa e të ardhurave përveç vitit 2025 që ne e kemi të miratuar, kemi të planifikuar 3 vite 2026.2027.2028, struktura është po e njëjtë është pjesa e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore që vlet nga strukturat e Bashkisë dhe ndërmarrjeve që ka në varësi, të ardhurat e veta që lidhen nga transfertat e pakushtëzuara që Qeveria Shqiptare i alokon Bashkisë, transfertat e kushtëzuara sektoriale për pagat, gjithashtu dhe trasnfertat e pakushtëzuara sektoriale siç janë shërbime që i kemi diskutuar disa herë, zjarrfikësja, arsimi parashkollor i mesëm gjithashtu, adminsitrimi i pyjeve, mjedisit, të cilat janë shërbime



që i janë atashuar bashkisë dhe buxheti i shtetit planifikon me transfertën e pakushtëzuar sektoriale, gjithashtu kemi dhe fonde të tjera kur këto marrëveshje janë të lidhura në rastin konkret me fondet IPA janë të parashikuara në burimin e financimit, mund të them që të ardhurat nga burimet e veta kanë një rritje 0.8% nga viti në vit dhe nga burimet nga pushteti qëndror ku përfshihen transfertat sa më lart që përmenda ka një rritje 2.1% duke e krahasuar me vitin 2026-2025, 2.9% 2027-2026 dhe 2028-2027 më pas dokumenti është i detajuar sepse të ardhurat janë dhënë të detajuara të cilat vijnë nga taksat apo tarifat dhe janë gjithashtu në mundet të shikojmë dhe si ak qënë viti 2023-2024 plani 2025 dhe për 3 vite në vazhdim, mbi bazën e të ardhurave të cilat ne kishim një pyetje si komision dhe morëm përgjigje në lidhje me trashëgiminë si destinacion janë të ardhurat e trashëguara që ne miratojmë në fillim të vitit. Pjesa e shpenzimeve është bazuar në 11 programe që ka bashkia.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pak më shpejt duan këshilltarët.

Këshilltare A.Përmeti: Po mirë po pastaj mund të kenë pyetje për këto që themi, kaq e kam shpejtësinë e lejuar e kam me standart, për pjesën e shpenzimeve këto janë paraqitur të detajuara dhe për çdo produkt brenda tij. Parashikimi që ka bërë në tre vite është pak a shumë njësoj për pjesën e shërbimeve dhe shpenzimeve sipas çdo kategorie të paraqitur, janë të ndara shpenzimet e personelit, ato koerente dhe shpenzimet kapitale sipas programeve, ne si komision pasi diktatuam e kaluam me 2 vota pro dhe 1 kundër për miratim në këshill, kjo është faza e parë dhe dua t'ju kujtoj se ka dhe dy faza të tjera.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ky ishte mendimi juaj si këshilltarë.

Këshilltar D.Osmari: Para se ta vazhdoj fjalën duke qënë edhe si kryetar i grupit të opozitës, do lutesha me shumë kolegëve sepse ne i kemi materialet dhe të bëhej një rezymë më e thjeshtë dhe më me pak detaje për arsye se janë 12 pika dhe secila ka rëndësinë e duhur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Por nuk jemi të gjithë njësoj.

Këshilltar D.Osmari: Sygjerim ishte dhe propozim sepse na shani ne pastaj kur na thoni ndonjë fjalë më shumë dhe e kemi me merak.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pa merak.

Këshilltar D.Osmari: Në lidhje me materialin sipas këtij informacioni të përgjithshëm që ne kemi mbi këtë program buxheti, thuhet në hyrje të tij, programi buxhetor afatmesëm është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disa vjeçare të burimeve financiare publike dhe parashikimit dhe lëvrimit të shërbimeve publike, si i tillë ai është një eksponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor por mesa unë konstatoj në këtë planifikim dhe planifikimet në të shkuarën, planifikimet janë me një imazh gabimi në realizim diku në 40 e ca % . Këtë e them që mos bëj spekulime, bëhet fjalë në vitet e kaluara deri në faktikun e 2024, realizimet e të ardhurat e kësaj bashkie janë në vlerat e 68 milion lekë, në një kohë ku planifikimet në të ardhmen bëhen 1 miliardë e 146 milion lekë, e 154, e 163, tani e kemi propozuar dhe herë tjetër nëpër mbledhjet ku kanë që diskutime për buxhetin që ky planifikim nuk është as realist, as i saktë nuk realizohet ju të gjithë e dini mirë dhe nuk ka si të realizohet.



Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po bëni koment apo pyetje?

Këshilltar D.Osmani: Edhe koment edhe pyetje, ta mbaroj unë fjalën pastaj vazhdoni, tani nuk u lodhet duke lexuar, u lodhët duke argumentuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Dhe ju e lexuat por vazhdoni.

Këshilltar D.Osmani: Lexova hyrjen që të jenë të qartë këshilltarët se çfarë është dhe për vete e kem. Tani në rastin në fjalë, rritja e vetme që ka Bashkia Korçë është rritja e administratës të saj, vetëm këtë rritje ka në shembull për gjithë Shqipërinë, konstatoj që në 2024 si pas këtij projektbuxheti kemi pasur 1103 punojës në një kohë që në 2025 kjo shifër shkon 1315 në totalin e saj, ku prapë sipas 2024 po t'i referohem asaj që në mbledhjen e mëparshme u miratua nga ky këshill por nuk isha fare dakort, ishte buxheti vendor i 2024 ku aktualisht Bashkia në 2024 ka patur sipas kësaj arsye 1122 punojës, nuk e di nëse këtu gaboju unë së lexuar apo Bashkia por mirë është t'i shikojmë. Në një kohë kur ne kemi turrje të popullsisë punojës të Bashkisë vetëm shtohen, nuk shikoj ndonjë shërbim të shtuar në bashki nuk kam vënë re dhe nuk pres, planifikojmë të ardhura 38 % të lart dhe vetëm për një arsye, për të mbuluar gjithë ato dështime që ju i keni dhënë bashkisë në vite sepse e theksoj edhe njëherë ju nuk keni asnjë mundësi ti mblidhni 1 miliardë e 100 milion lekë nga kjo bashki ku deri më sot maksimumi që keni mbledhur ka qënë viti 2024 me 680 milion lekë dhe këto vetëm 2.8% e tyre ka shkuar për investime për përdorim të qytetarëve, të tjerat kanë shkuar rrush e kumbulla për paga për punojësit tuaj të cilët pa dashur të ofendoj ata që punojnë shumica dredhin zinxhirin nëpër qytet nëpër biznese dhe punët e tyre. Në një kohë tjetër hapim dhe shohim përsëri kemi shpenzime sepse të diskutosh për një projekt afatmesëm, kemi shpenzimet e vetme për investime tek ky projekt buxhet që unë shikoj vetëm disa pasqyra në miniaturë të jenë sa më të vogla pa dashur të spekulloj për çfarë qëllimi bëhen sepse nuk kanë asnjë shpjegim janë vetëm disa pasqyra të bashkëngjitura këtu që dhe unë si economist apo kolegët e mi economist me përvojë e kanë të vështirë t'i shtjellojnë sepse nuk ka informacionin e duhur, do të thoni që ky është standarti, po ky është standarti por ka disa tabela atje poshtë ku kërkohen disa shpjegime për çdo tabelë, sepse i vetmi investim që shoh unë këtu thashë qofsha i gabuar është investimi i termoizolimit të banesave që është në projekt nga 2025-2028 me 10 milion lekë të reja dhe asgjë tjetër, nuk kam gjë tjetër këtu. Konstatoj se nëse të ardhurat e bashkisë tek ky projektbuxhet kemi faktin e 2023 dhe 2024 marrim dhe bëjmë një bazë krahasimi dhe për atë që ju mendoni se do realizoni në vitet në vazhdim në një kohë që për shpenzimet ky fakt as për 2023 as për 2024 nuk është i vendosur këtu është 0 nuk ka asnjë bazë krahasuese dhe nuk kemi me kë ta krahasojmë se çfarë është rritur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mbaruat?

Këshilltar D.Osmani: Jo.

Këshilltare A.Përmeti: E ka shumë të shkurtër.

Këshilltar D.Osmani: Të paktën nuk e kisha lexim Ada, nuk lexoj materialin ato që them. Nëse do të bëjmë debat e bëjmë, të ftoj në debat.



Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem mos u merrni me njëri-tjetrin, vazhdoni jepni mendimin tuaj.

Këshilltar D.Osmani: Komentet i bën ekzekutivi dhe nuk ka nevojë t'i bëjë njeri nga këshilli sepse secili ka zgjuarsinë e tij.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mos bëjmë debate të panevojshme.

Këshilltar D.Osmani: Debatet nuk i nisa unë, as fjalën nuk e ndërpreva unë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Vazhdoni.

Këshilltar D.Osmani: Faleminderit znj.kryetare që na jepni dhe fjalën se duhet t'ja u dimë edhe për nder, të paktën na i lini këtë se shumë të tjera na i keni marrë, na lini fjalën të paktën.

Këshilltar D.Osmani: Vijmë tek shpenzimet, ashtu siç e thashë shpenzimet nuk kanë bazë krahasuese, nuk kanë asnjë rakordim njëra me tjetrën sepse nuk ka si ne t'i rakordojmë apo krahasojmë ato sepse i kemi 0 këtu dhe nuk e di si e kanë lexuar kolegët e mia dhe kanë gjykuar se ajo është e saktë dhe e drejta, shikoj që këto shpenzime ndryshojnë vetëm atje ku për arsye të propagandës duhet të ketë rritje, por në momentin e dytë ato janë qëllimisht të fryra sepse në momentin që ne flasim ato janë shumë pak të realizueshme. Po ju jap një fakt 38% të të ardhurave do realizohen nga këto, 72% janë në shumë taksa e ndikimit mbi infrastrukturë dhe ndërtimet e tjera, sepse do vijmë në një moment të dytë që do bëjmë dhe miratimin e realizimit pastaj qoftë të vitit 2025 qoftë të planifikimit të 2026, por konstatoj që ashtu si ka ndodhur edhe në vitet e tjera ashtu do ndodhë, ashtu siç ndodhi edhe në vitin 2024 që në totalin e të ardhurave të kësaj bashkie vetëm 39% janë nga taksat dhe tarifat pjesa tjetër është nga transfertat e pakushtëzuara dhe kjo transfertë kjo bashki ngelet peng në çdo kohë dhe vazhdon të rritet pengu kundrejt shtetit dhe qeverisë qendrore, kjo është arsyeja që ne të bëjmë një planifikim më të qartë që ky vend dhe ky qytet të ketë më shumë njerëz, më shumë të rinj.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: Si është konisderuar demografia dhe trendi i ndryshimeve të popullsisë në përpilimin e kësaj faze të parë të programit buxhetor afatesëm 2026-2028?

Këshilltar K.Pllaha: Faza e parë e këtij projekti është faza strategjike dhe unë u mundova të lexoj strategjinë e bashkisë dhe e nisa nga strategjia e zhvillimit afatgjatë, më falni që po i referohem kompjuterit por nuk e kishim të printuar materialin, kështu që e kam këtu dhe me thënë të drejtën kjo strategji mu duk shumë e bukur gati endrrimtare, problemi është që tek strategjitë e projektbuxheteve afatmesme nuk e shikoj këtë të ndikuar nga kjo strategjia afatgjatë. Atëherë mendoj sa afatgjatë është kjo strategji nuk ka mjetuar 18 vjet për zhvillimin afatgjatë të qytetit?

Po i marr me radhë qëllimet: Qëllimi i parë thotë Korça si një qendër kryesore ekonomike, administrative dhe arsimore, ndërkohë që shikoj në projektbuxhet që mbështetja për zhvillimin ekonomik vendor një nga zërat e shpenzimeve është në nivel shumë të ulët dhe nga ky nivel i ulët janë



vetëm 95 milion lekë të vjetra që janë në formatin e investimeve dhe si mund të zhvillohet ekonomia pa investuar në qëllimet në zhvillimin ekonomik, si mund të zhvillohet ekonomia kur vetëm 68 biznese përfitojnë nga lehtësitë fiskale nga 3400 mos gaboj të rregjistruara në Bashkinë e Korçës, a nuk ka erdhur momenti t'i japim pak më shumë rëndësi zhvillimit ekonomik duke subvencionuar bizneset, duke ulur shpenzimet e personelit të Bashkisë në kohë kur popullsia vjen në rënie në rritim stafin e bashkisë, nuk është momenti të kursojmë pak në shpeznime personeli, në eventet që organizon Bashkia dhe të stimulojmë zhvillimin ekonomik të bizneseve?

Përsa i përket po tek objektivi 1 është zhvillimi arsimor ndërkohë shikoj tek projektbuxheti afatmesëm ka një ulje të të transfertës të kushtëzuar për pagat e punojësve të arsimit parauniversitar nuk e di nga vjen nga ulje, do ketë shkrutim të punojësve apo ulje të pagave. Në qëllimin nr.2 shoh turizmin dhe të vetmet mënyra për të zhvilluar turizmin shikoj promovimin dhe eventet, pra nuk ka investime por ne shohim që në Korçë mungon qoftë edhe një tabelë informuese.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Pllaha më fal që ju ndërpres se po bëni komente dhe jo pyetje, tani do e kërkon fjalën prapë për komente apo do i bëni bashkë?

Këshilltar K.Pllaha: Po i bëj bashkë, komentet janë parashtrimi i pyetjeve dhe brenda fjalës time ka shumë pyetje, për turizmin në Korçë mungon tabelë informuese për pikat turistike të qytetit ku ndodhen muzet e qytetit, mungon tabela informuese për oraret e urbanit, mungon një sajete që të jetë i përgjithshëm për të gjitha pikat e shërbimit turistik që ofron qytetit, tek promovimi i turizmit thotë promovimi i mëtejshëm i trashëgimisë kulturore duke mbrojtur ndërtesat historike dhe rrugët me kalldrëm këtë pikë në buxhetin e kaluar e kam kërkuar të merren parasysh ndërhyrjet tek ndërtesat që kanë një vlerë historike tradicionale dhe më është thënë nuk është kompetencë e bashkisë, ka ndryshuar diçka?

Tek qëllimi 3 që për mua është shumë i rëndësishëm, Korça si qytet kompakt i larmisë humane kohezioni social i cili pretendohet se do arrihet duke bërë integrimin e duhur të zonave informale, sa është parashikuar në ky projekt buxhet integrimi i zonave informale sepse unë shikoj që zonat informale nuk po marrin vëmendje nuk ka investim në to, duke filluar nga ajo që u përmend disa pika më parë tek zona e banesave me kosto të ulët ku rreth e rrotull tyre nuk ka kënd lojrash, nuk ka investime të mirëfillta që t'i integrojnë këto dhe mos kthehen në geto. Tek zona e ish-Smt ka akoma rrugë me probleme nuk janë bërë investime dhe nuk janë formalizuar. Qëllimi 3 është pjesa e Kodrave të Moravës që do përdoret si kurorë e gjelbër për Korçën dhe nuk shoh prapë në buxhet sa është fondi i pyllëzimit për Kodrat e Moravës dhe meqënëse gjej rastin ta përsëris këtë është bërë një iniciativë shumë e bukur qytetare për mbjelljen e disa pemëve aty, të cilat kanë nevojë për përkujdesje dhe gjej rastin të bëj një ftesë që Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të kujdeset për to që mos humbasë kjo vlerë e shtuar që qytetarët japin qytetit. Qëllimi nr.4 zhvillimi i qëndrueshëm për një qytet prej 100 mijë banorësh, ndërkohë që ne shohim që plaga më e madhe e gjithë provinacave të Shqipërisë përveç metropoleve Tiranë-Durrës është zbrazja e popullsisë, si i inçentivon Bashkia jonë të rinjtë që të qëndrojnë këtu



nëpërmjet mundësisë për të marrë banesa me kredi të buta, si e inçentivon biznesin apo vetëm duke shtuar administratën e bashkisë?

Këto janë pyetjet e mia, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëherë nëse nuk ka diçka tjetër nga këshilltarët fjala për ekzekutivin të japë përgjigje për pyetjet e bëra dhe të bëjë komente mbi koment.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Meqënëse unë do ju jap përgjigje pyetjeve, do bëj dhe diskutime nuk e di si do e menaxhojmë mbledhjen, po i bëj njëherë unë këto që kam pastaj vazhdojmë. Shumë faleminderit edhe për pyetjet edhe për komentet, edhe për vëretjet, sidomos për ato vëretje që qëndrojnë dhe nuk janë në kuadër p[olitic dhe nuk kanë ndonjë vlerë nga mbrapa, tani patjetër që diskutime për buxhetet në përgjithësi janë diskutime që vlejné për sa kohë që në çdo bashki kërkesat dhe nevojat në raport me burimet sidomos burimet financiare kanë një diferencë goxha të madhe dhe është përgjegjësia jonë dhe e juaja që ato mundësi fianciare që kemi t'i shpenzojmë në mënyrën më të mirë të mundshme për të plotësuar dhe detyrimet ligjore që kemi por edhe për të hapur prespektiva zhvillimore. Tani duhet të kuptojmë së bashku që projektet që financohen në qyetetin e Korçës jo detyrimisht të gjitha mbështeten financiarisht nga buxheti i Bashkisë, ka shumë projekte që mbështeten nga Ministria apo institucione të ndryshme të saj dhe donatorë të ndryshëm e thashë këtë sepse jo çdo buxhet madhor mund ta gjeni tek buxheti i Bashkisë por kjo nuk do të thotë që puna e institucionit limitohen vetëm në projektet që fianancojmë vetë, projektet e mëdha nuk fianncohen nga buxheti i bashkisë ndaj dhe nuk i shifni këtu. Kompozimi i buxhetit është e vërtetë që buxheti ynë ka tre grupe kryesore zërash janë pagat dhe sigurimet shoqërore, shpenzimet operative dhe investimet por më duhet t'ja u riqartësoj edhe njëherë që puna jonë nuk matet me fondet që ne lemë për investimet sepse nuk jemi një ndërmarrje e thjeshtë investimesh, ka shumë funksione që kryhen Bashkia të cilat nuk janë në grupin e investimeve, janë në grupin e shpenzimeve operative por janë po aq të rëndësishme sa investimet, në raport me përditshmërinë e qytetarëve përshtembull në grupin e shpenzimeve operative janë të gjitha shërbimet që lidhen me pastrimin, ndiçimin, gjelbërimin, mbështetje për artin, për sportin, transporti dhe një pjesë të investimeve për shkak se ne për eficiencë të përdomrimit të punimeve i kemi të paraqitura si blerje materialesh, qoftë ky asphalt, apo pllaka dhe pastaj i realizojmë praktikisht me punojësit e NSHP nga pikëpamja strikt financiare duken si shpenzime operative por në fakt janë investime që i kemi zhveshur nga puna por janë fiks investime po ti kisha prokuruar bashkë me punën do ishin në zëri invetime, pra nuk është struktura e buxhetit të bashkisë ajo që ju shihni po të bëni thjesht pjestimin e raportit me totalin e shpenzimeve por edhe sikur të ishte ajo shumë nga shpeznimet operative janë funksione dhe shërbime që ne ja u ofrojmë qytetarëve sesa një rrugë që mund të investoja unë sepse prekin një numër të madh përfituesish qoftë në qyetet apo fshat. Pika tjetër që doja të theksoja lidhet me pjesën e shpenzimit të personelit dhe numrin të punojësve u thanë shifra të ndryshme, ne kemi dy numra të punojësve. Një është numri që kemi në planifikimin tonë dhe e dyta është numri faktik i punojësve nuk besoj se kemi eficiencë 100% të shfrytëzimit të burimeve



njerëzore por nuk besoj se jemi në krahun ekzagjerimit për të mbuluar ato shërbime që ofrojmë, kemi dhe një grup punojësish që ne i marrim sezonalë nuk i marrim gjatë gjithë vitit, për punojësit kur të mbaroj unë të flasë Anxhela për strukturën pasi jam i sigurt që nuk ka rritje të tipit nga 2100 në 2023 në 2300 në 2024 nuk ka shans se çfarë ke lexuar do e sqarojë Anxhela. Tjetra që lidhet me planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve është një diskutim që vazhdimisht e bëjmë në çdo buxhet të fundvitit dhe në çdo diskutim për buxhetin afatmesëm e keni thënë qëndrimin tuaj dhe unë e kam thënë qëndrimin tim, për mua e rëndësishme në finale është që shpenzimet faktike vjetore të Bashkisë Korçë mos tejkalojnë të ardhurat faktike vjetore të kësaj bashkie, mos krijojmë gropa financiare, kjo është më e rëndësishme për mua por besoj edhe për ju. Unë kam preferuar të kemi parashikime optimiste qoftë në krahun e të ardhurave qoftë në krahun e shpenzimeve por nga ana tjetër kemi qënë vazhdimisht që mos bëjmë shpenzime të pabalancuara dhe fakti ka treguar që nuk kemi vite buxhetore këto vitet e fundit të paktën nuk ka pasur gropa financiare, mund të ndiqja dhe atë këshillën tuaj mos i kisha të listuara në buxhetin vjetor gjithë shpenzimet apo investimet që parashikojmë të bëjmë me të ardhurat por në asnjë rast nuk ka ndodhur që ne të kemi gropa të mëdha financiare dhe besoj jemi mirë. Përsa i takon zhvillimit ekonomik vendor dhe mbështetjes me buxhet patjetër që unë mendoj që në këtë mandate apo ato në vazhdim i është vënë projekteve që lidhen me zhvillimin ekonomik vendor dhe me krijimin e mundësive më të mira të të ardhurave për çdo familje të kësaj bashkie. Zhvillimi ekonomik është një koncept i gjërë dhe shumë projekte të para direkt ose indirekt kanë impakt në zhvillimin ekonomik vendor u fol dy herë dhe u kritikua Bashkia sepse organizon evente, këto evente kanë dy lloj përfituesish, të parët janë komuniteti jo në peshë në fakt por po i listoj sepse eventet gjallërojnë jetën ekonomike, artistike të qytetit dhe ja u kam thënë disa herë, jemi një komunitet bashkësi njerëzish të gjallë dhe kemi nevojë për mbushjen e kohës dhe këto evente i shërbejnë kësaj dhe i shërbejnë shumë zhvillimit ekonomik sidomos në sektorin e turizmit dhe kjo nuk është një shpikje e Bashkisë Korçë e ka implementuar e para strategjinë e një pakete eventesh jo unë kryetari që ka qënë para meje, por bota i ka të ngritura në përmasa të jashtëzakonshme, mënyrën si organizohet dhe si i përkthejnë në ekonomi nuk i kemi shpikur ne, ne po përpiqemi t'i zbatojmë bazuar në kapacitetet dhe burimet financiare që kemi. Dakort që vihet theksi tek zhvillimi ekonomik dhe hajde ta bëjmë dhe si do mbështetën por mos limitohet zhvillimi ekonomik vetëm në incentive për biznesin, mund të ketë më shumë incentiva për biznesin por në rast se limitohet ai vizione për zhvillimin ekonomik vetëm në çfarë incentive do i ofrojmë biznesit këtë nuk e qas dot dhe biznesi është përftiues direkt dhe indirekt i të gjitha projekteve tona zhvillimore ata që janë të punësuar kanë vetëm pagën, biznesi ka mundësinë e të fituarit nga biznesi që bën. Po them disa fjalë për zhvillimin ekonomik, ne kemi indentifikuar si bashki disa drejtime të zhvillimit ekonomik bazuar në potencialin që ne kemi turizmi një sektor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik, buqësia, blegtoria dhe agropërpunimi, kemi futur e kemi sjellë si risi pjesën e teknologjisë dhe inovacionit si mundësi punësimi për të rinjtë dhe të rejat që të marrin njohuri dhe të mos limitojnë vetëm me punësimin fizik nëpër këto institucione por të punojnë edhe për tregun ndërkombëtar, objektivi i katërt arsimit potencialin që kemi si qytet për tu kthyer në një qendër arsimore të nivelit të mesëm edhe të nivelit të lartë jo vetëm t'ju ofrojmë arsimin të rinjve tanë por edhe të tërëqim të rinjtë e tjerë nga qytete të tjera. Projekti i Liceut Franzes nuk e gjeni në buxhet sepse nuk jemi duke paguar ndonjë lekë por projekti po ec. Fondi Shqipar i Zhvillimit ka marrë fonde për të ndërtuar edhe dy godina të tjera që së bashku me godinën historike do bëjnë komposin e këtij liceu, është përgatitur gjithë dokumentacioni për hapjen dhe presim ta hapim në vitin 2026-2027 këtë Lice por ju nuk e shihni këtë



gjë në buxhet, Poli i Dijes që po bëhet tek i njëjti vend do ketë një infrastrukturë në bashkëpunim me Universitetin "Fan Noli" por edhe me insitucione të huaja do ju krijojë mundësi të rinjve dhe të rejave duke ju ofruar parametra bashkëkohore të lidhura me qëndra kërkimore. Po i rikthehem pak atij debatit, debatin e fillove ti që nuk po respektoje kolegen që po fliste për mua mund të vini një limit kohor që gjithësecili nga këshilltarët brenda atij limiti të flasë çfarë të dojë, se këtu juve keni të drejtën tuaj të thoni çfarë të doni. Nuk besoj se po ju mërzit? Sepse nuk po përsërit ndonjë gjë që u tha deri tani dhe po jap informacion njërit nga këshilltarëve që t'i dini disa zhvillime dhe nëpërmjet jush t'i mësoje dhe komuniteti. Përsa i takon sektorit të teknologjisë jemi duke punuar shumë në këtë drejtim besoj në potencialin që ka teknologjia dhe informacioni për të krijuar mundësi punësimi por nuk është rrugë e lehtë kemi shembuj që një pjesë e të rinjve tanë e kanë gjetur këtë rrugë nëpërmjet trajnimeve tona dhe do investojmë shumë në këtë drejtim që nga moshat evogla dhe deri në moshat që mund të përfshijë. Për pjesën e truizmit, është e vërtetë që turizmi ka dhënë shumë në pjesën e ekonomisë, numri i vizitorëve është rritur shumë por është e vërtetë që jemi në një moment kritik pasi deh situata nuk është statike është në lëvizje duhet të shtrihemi dhe në vizitorët e huaj, mbaruam një projekt me mbështetjen e BE dhe Berzhit në kuadrin e të cilit është zhvilluar edhe websait përkatës Korça turizëm.al.

Këshilltar K.Pllaha: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po të duash tërhiqe po të duash jo, unë do preferoja kur të flisnit të kishit një informacion paraprak., Duhet t'ja u çoj me një mesazh të gjithëve.

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pra këtij kush ka qënë e di?

Sepse ka pasur dhe websait të tjera, nuk e di Devis për shkak se nuk ke qënë asnjëherë i interesuar që të marrësh informacion për këtë gjë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do ju lutesha këshilltarëve jo më debat me kryetarin, ju lutem tani. Z.Osmani ju lutem të mbarojë, mos hyni në debate personale, të mbarojë kryetari nëse keni diçka vazhdoni.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ka shumë përpjekje për ta mbështetur akoma më fuqishëm sektorin e turizmit, që nga riorganizmi i zyrës të turizmit në Bashki dhe deri në projekte me mbështetje të donatorëve të huaj të cilët përpiqen të adresojnë ato të cilat janë sfidat e turizmit, që është një marketing më i mirë i potencialit tonë turistik, një shtim produkteve turistike, një qasje rajonale ndaj produktit turistik dhe këto besoj të gjitha do sjellin atë që ne presim një shtim të fluksit turistik dhe zgjatjen e saj, në mënyrë të detajuar se çfarë jemi duke bërë prej secilën prej tyre më thoni sepse nuk dua të zgjatem. Për pjesën e buqësisë dhe agropërpunimit dhe ai me sfida shumë të rëndësishme, për pentarinë do ketë një fermë moderne të rritjes të mollëve me gjithë teknikat më moderne të kohës, do ketë një qëndër të paketimit të mollës dhe një laborator të tokave buqësore dhe të gjitha këto do jenë në funksion jo vetëm të krijimit të një modeli por edhe vënies në



funkcion të gjithë fermerëve që janë në këtë sektor, këto ditë do lançohet një skemë e Qeverisë Shqiptare për subvencion për fermerët do fillojmë dhe takimet me fermerët potencial e cila mbështet mekanikë kryesore këtë pjesën e sistemeve përsëri rrjetave, vaditje me pikave, pjesën e agroturizmit do kemi një takim më të zgjeruar jeni të ftuar të merrni pjesë ata që kanë interes për këtë sektor, jemi duke punuar për secilën nga këto fusha të ekonomisë, jemi të hapur të dëgjojmë edhe ide apo propozime për sektorë të tjerë që kanë potencialin për tu zhvilluar në Bashkinë e Korçës bazuar në ato resurse që ne kemi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit z.kryetar, po i jap fjalën drejtoreshës juridike.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Në vitin 2024 numri total i punojësve i Bashkisë dhe institucioneve të varësisë ka qënë 1328 në plan, për vitin 2025 u bë 1334 u bë një shtesë prej 6 punojësish, 3 janë në Qendra e Artit dhe Kulturës dhe 3 në Ndërmarrja Mbështetëse e Arsimit, numri prej 1303 të cilit i referohesh është numri në fakt pra punojësit që janë të punësuar në fakt jo në plan dhe ti krahason këto.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Këtu hyjmë në fushën e spekulimit, pasi krahasimi duhet bërë ose fakt me fakt ose plan me plan, krahasimi fakt me plan është spekulim.

Këshilltar D.Osmani: Tani.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të mbarojë drejtoresha se mbase e gjeni përgjigjen.

Këshilltar D.Osmani: E mbaroi pra ana e tha.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jo nuk e ka mbaruar.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Ky ishte thelbi, nëse e do të detajuar sa janë sipas institucioneve më thuaj.

Këshilltar D.Osmani: Tani të vazhdojmë me debatin me z.kryetar, spekulim mund të jetë kur unë t'i shpik shifrat por kur unë i lexoj sipas këtij projekt raporti, fqja 19 në një tabelë tuajën është.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar D.Osmani: Më dëgjo, unë të dëgjova, ku është fakti tek kjo tabelë?

Drejtorja e Financës V.Ziko: Tek faqja 19 e kam dhe unë.



Këshilltar D.Osmani: Këtu janë 5 vite tabela, nuk është fakt 2025 është plan.

Drejtoria e Financës V.Ziko: Mundt ë flas unë të ta shpjegoj?

Këshilltar D.Osmani: Të flas unë për spekulimin që bëra.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Para se të kalojmë atje me shpjegimin që dhamë, jemi të qarte që jemi rritur me 6?

Këshilltar D.Osmani: Të vazhdoj unë me pjesën e spekulimit, kjo tabelë ka vitet që nga 2021 deri 2025 që do të thotë deri në 2024 janë ato që janë realizuar dhe këtu nuk shkruhet faktik është por një person me pak intelekt e di që është faktik 1303 në një kohë që ju planin e keni për 2025 që këtu nuk e di ku quhet spekulim të shkoni në 1315 punojës mbi cilën bazë mendoni të shkoni 1315 punojës ku në qytet ka tkurrje të popullsisë, ka ulje të numrit të familjeve, ulje të atyre që dëshirojnë të jetojnë në këtë qytet, jo për mirë sepse besoj se nuk është diçka e mirë që njerëzit kërkojnë të ikin as për ne si opozitë por as për ju si mazhornacë por shifrat këtë po lexoj dhe prandaj ju pyeta mbi cilën bazë mendoni ta rritni, unë po lexoj tabelën dhe kjo tabelë kështu thotë, të shkojë 1315 se ju vërtet keni planifikuar të shkoni 1306 nga 1303 këtë unë ku ta shikoj dhe ku ta lexoj bihem dakort z.kryetar që duhet të kishte një analizë më të detajuar të këtyre tabelave?

Vetëm një po ose jo.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Spekullimi ishte në faktin që u tha është rritur numri i punojësve me 200, nuk është rritur.

Këshilltar D.Osmani: Është planifikuar thashë nuk thashë është rritur.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E kam keqkuptuar unë, po e sqaroj atëherë që numri faktik ka lëvizur me 6, edhe diçka që lidhet me pjesën e shpenzimeve në tërësi me atë diskutimin balancë të ardhura shpenzime edhe me pjesën e personelit po të ishte që unë si kryetar bashkie, të futja njerëz dhe të mbushja vendet me punë për përfitime të tjera politike më beso që ky numër 1300 nuk do ishte numri në plan por numër faktik, kemi operuar me shumë kursim në këtë drejtim, madje në disa struktura ku detyrimin ligjor e kemi t'i kemi në nivel drejtorie ne i kemi nivel sektori të plotësuar dhe një drejtori minimumin e ka 7 punojës, unë nuk i kam drejtori i kam sektorë po të doja t'i bija me top i kisha rënë.

Këshilltar D.Osmani: Tani unë nuk thashë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Osmani mos bëni debat pa kërkuar fjalën sepse nuk jeni vetëm ju ka dhe të tjerë që do diskutojnë.

Këshilltar D.Osmani: Unë nuk të akuzova për diçka, kur ka qënë se ju dhe stafi juaj keni pasur të drejtë pa ç'ka se pjesën politike ka krahun e tij por këtu jemi këshilltarë të këtij qyteti dhe dashur pa dashur na intereson ose të paktën mua më intereson e ardhmja e këtij qytetit sesa pjesa që ne spekulojmë mbi faktet sepse dhe pjesa që ne debatojmë apo nuk jemi dakort me atë që administrata juaj bën kjo duhet të jetë një pikë jo sirenë alarmi por të jetë një pike referuese që dhe ju t'i merrni parasysh se me punën e kartonave vetëm sot ju duhemi që të jemi 21 se po të jetë për të tjera e dimë që nuk keni ç'na doni por do na respektoni se nuk keni çfarë të bëni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju kemi respektuar dhe ja u kemi dhënë fjalën dhe keni shprehur mendimin tuaj më shumë se këshilltarët socialistë.

Këshilltar D.Osmani: Fjalën ma jep e drejta e këtij vendi, vota e qytetarëve asnjë këtu.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju respektojmë për kontributin e dhënë.

Këshilltar D.Osmani: E vlerësoj nga ana juaj.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë sqarim nga ekzekutivi, nëse jo koment nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: Për procedurë znj.kryetare kam përshtypjen që bëra një pyetje në lidhje me demografinë dhe nuk mora përgjigje.

Këshilltar D.Osmani: Ky është vazhdimi i fjalës të kryetarit dhe unë mbajta disa pika shënim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po bën komente mbi fjalën e kryetarit?

Këshilltar D.Osmani: Jo komente thjesht për të vënë disa gjëra që janë të qartë, në bazën e asaj për të cilën jemi duke diskutuar mbi bazën e fuqisë punëtore që ka Bashkis dhe besoj se të gjithë përsëri biem dakort që bëjnë atë që duhet të bëjnë, një pjesë të urojmë që të vijnë në punë se nuk duam të bëjmë prokurorin sepse shumë mirë ju bëjmë foto ku janë edhe por nuk jemi për këtë këtu, tani të shtohen gjatë sezonit veror personel për vadijtje dhe shërbime të tjera, unë mendoj që nuk është nevoja të shtohen por me ata punojës që kemi mund ta menaxhoni shumë mirë situatën, çështje tjetër parashikimet që bëni për vitet në vazhdim janë shumë optimiste por të pa realizuara nuk është nevoja të bëjmë 1 miliardë e ca parashikime kur nuk i kemi të realizuara në 40% e tyre se pastaj dhe ajo pjesa që ju thatë që nuk kemi gropa financiare ndoshta është e vërtetë por keni gropa në investime, e vërtetë është që eventet duhen bërë por çështja është që pas kaq vitesh duhet bërë dhe një analizë e këtyre evente se çfarë na kanë sjellë, kemi ndonjë përfitim të tyre apo duhet ndryshuar sepse ndoshta në 10



vite e dha efektin dhe duhet parë që këto fonde për këto evente nuk duhet të jetë në këtë nivel sepse ka fluks në rënie për turizmin sepse të paktën nga informacioni që kam që ka shumë bujtina që mezi po mbi jetojnë dhe i kanë nxjerrë në shtije shumica verifikojeni z.kryetar dhe nëse nuk e di sepse të jesh i sigurt që është i vërtetë. Përsa i përket buqësisë dhe agrotruzimit unë e mbështes nismën që keni marrë por duke qënë pjesë e asaj fushe për shumë vite të këshilloj nëse bëhet të jetë produktive për gjithë fermerët sepse në shumë raste historia ka treguar që menaxhimi i këtyre burimeve nga shteti nuk ka qënë produktiv, në fund fare përderisa dhe ju e merrni përsipër ta investoni mirë është të kemi një produkt i cili të jetë mire menduar me gjithë faktorët që janë në fushën e buqësisë, qoftë fermerët, qoftë bizneset e magazinimit, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, z.Tollkuci fjalën.

Këshilltar P.Tollkuci: Përsëritet të nderuar kolegë, është një moment shumë i rëndësishëm për mua pasi e para është një hap ligjor miratimi i programit buxhetor afatmesëm por ashtu si kundër unë kam diskutuar dhe për buxhetin vjetor për këto buxhete që ne kemi miratuar dhe kemi bërë analizën e tyre si këshilltarë deri në momentin që do jemi këshilltarë. Është optimizmi në ndërtimin e buxhetit sepse nuk mund të jetë një buxhet i njëjtë me vitin e kaluar, ne të gjithë e dimë shprehjen "I have a dream" dhe ne të partisë socialiste kemi patur një endërr kur morëm bashkinë në 2007 dhe atë endërr e kemi bërë realitet duke hartuar këto buxhete, ato që ne kemi prekur nuk ka nevojë të komentohen, por sigurisht ne kemi të drejtë që të kërkojmë më shumë sepse jemi tatimpagues të këtij qyteti dhe duhet të kërkojmë më shumë nga kryetari dhe ekzekutivi. Nuk është e thënë që buxheti duhet të realizohet në masën 100%, jemi në kushtet e buxheteve reale, kolegu e kërkoi drejt bazën demografike dhe buxhetet mendoj unë ndërtohen mbi bazën ekzistuese duke qënë se unë kam qënë pjesë e administratës dhe gjithmonë janë ndërtuar mbi Bza ekzistuese. Ajo që përmendi kryetari gjetja e burimeve të tjera të cilat unë dua të përmend faktin që në vitin 2007 kur unë kam qënë drejtor i taksave nuk kishim burime për të investuar për hir të së vërtetës ne kemi qënë Bashkia e parë po them që kemi aplikuar për kredi në një bankë të nivelit të dytë dhe duhet t'ja u bëj me dije se është bërë një studim fleksibiliteti nga dashamirës dhe ndihmues siç ka qënë USAID dhe është parë që Bashkia e Korçës mund të marrë kredi dhe ta shlyej. Buxheit afatmesëm që ne i referohemi janë rrezet e diellit për buxhetin afatgjatë unë them është i bazuar në eksperiencën më të mirë të viteve paraardhëse, pa një pasqyre të ardhurash, shpenzimesh ne nuk kemi ku të shkojmë asgjëkundi. Kush ka qënë në atë promovimin që Bashkia Korçë ka organizuar në turizmin jo vetëm në Bashkinë e Korçës sepse unë gjykoj faktin që turizmi nuk shihet si monopol i Bashkisë Korçë por gjithë Qarkut është bërë dhe logoja e Bashkisë Korçë The Heartland besoj se është hedhur një hap shumë i rëndësishëm për të ardhmen, po t'i lexojmë të gjitha faqet e buxhetit e kuptojmë që buxheti është hartuar me përgjegjshmëri, besoj që ne kemi miratuar 2 projekte që ishin investimet që u bënë për ndërtimin e shkollës "Sotir Gura" dhe të Pallatit të Sportit të cilat janë jo vetëm investime të Bashkisë Korçë por të ndërthurura me ministrinë përkatëse dhe me Fondin Shqiptar të Zhvillimit kohët e fundit kam marrë vesh dy investime shumë të rëndësishme shtrimi me asfalt i një rruge problematike që është thënë dhe nga kolegët e opozitës Polenë-Dërsnik, por edhe tek ish-Artisatjka lagjia 6 e cila ka qënë sërish problem, jo se janë zgjidhur të gjitha problematikat që ka komunitetit por është detyra e Bashkisë hap pas hapi, vit pas viti të zgjidhen këto probleme, prandaj dhe



hartohen projektet vjetore kështu që të nderuar kolegë ju falenderoj të gjithë për kohën që më dëgjuat, ju ftoj ta votoni projektbuxhetin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, z.Tollkuci, fjala për z.Petri.

Këshilltar L.Petri: Faleminderit znj.kryetare, unë do e votoj kundër jo sepse nuk bie dakort me fjalët e kolegëve parafolës dhe z.kryetar, unë për vete një pjesë që u nënshtrua këtu e mbështes, fjala vjen Liceun Franzes e mbështes që do rikthehet apo qendrat e ekselencës por gjykoj që ndjesia ime këtu është sepse dhe z.Tollkuci gjëja e parë që tha ishte që ta votojmë sepse është detyrim ligjor, ju lutem mos na kompleksoni duke na thënë që është detyrim ligjor sepse kemi tagrin e plotë si njësi e qeverisjes vendore që të votojmë pro apo kundër për çdo pikë që na parashtrohet, ndjesia ime këtu është që me çdo pikë që na jepet po flas në nivel vetjak është sikur jam në fund të pusit ajo bretkosa që shikoj atë qiellin edhe më thuhet voto për gjithë qiellin sepse ky është qielli. Kështu që pa dashur të hy në detaje teknike të tjera të cilat dhe z.Osmani i parashtroi unë mendoj duhet të punojmë fort që të bëhen parashikime më realiste të lidhura me demografinë, me turizmin që është i brishtë disa vite mund të ecë, disa vite jo dhe nuk mund të fshihemi si struci e të themi ne jemi optimist prandaj po bëjmë këtë lloj programimi buxhetor dhe nga ana tjetër arkëtimi mos jetë i dëshiruar, kështu që për të gjitha këto unë votoj kundër, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka diçka tjetër nga këshilltarët?

Këshilltare A.Përmeti: Dua të theksoj dhe diçka tjetër që u diskutua në komision dhe u tha nga ekzekutivi që Bashkia Korçë u vlerësua e para nga Ministria e Financave dhe për cilësinë e dokumentacionit dhe paraqitjes në mënyrë analitike, gjithashtu dokumenti i projektbuxhet afatmesëm me analizë dhe të performancës dhe gjithë planit dhe strategjisë është i vetmi që paraqitet në mënyrë të detajuar dhe mund ta gjesh online, Pjesa e seriozitetit që Bashkia harton buxhetin është në nivel maksimal, kjo nuk lidhet me projektbuxhetin 2025 ky është buxheti afatmesëm 2026-2028 nëse ne nuk miratojmë këtë projektbuxhet tregojmë që nuk kemi një përjasje të duhur në lidhje me atë që qytetarët kërkojnë, shkolla më të mira, programe sociale më të mira dhe doantorët vlerësojnë përjasjen pasi nuk vijnë sepse janë korçarët e bukur por shikojnë dhe investojnë, nuk është se ju po nuk emiratuat Korça nuk do ketë shërbime ajo do ketë por duke mos e miratuar dhe tregojmë përjasjen tonë jo në nivelin e duhur të cilit i takon ky material.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka diçka tjetër por jo për të bërë replikë me njëri-tjetrin, nëse nuk ka e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 17

Vota KUNDËR 5

Vota ABSTENIM 0



Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 17 pro, 5 kundër, 0 abstenim.

**Pika 8 e rendit të ditës.**

**PËR NGRITJEN E KËSHILLIT VENDOR PËR SIGURINË PUBLIKE NË BASHKINË KORÇË.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni i ligjeve ju lutem.

Këshilltar K.Kocibelli: Në lidhje me këtë pikë ka të bëjë me ngritjen e këshillit vendor për sigurinë publike në Bashkinë Korçë, fillimisht është miratur një vendim i Këshillit të minsitrave nr.678 të vitit 2024 dhe kjo vjen me propozim të Prefektit të Qarkut Korçë i cili ka ndërmarrë hapa për ngritjen e për ngritjen e komisioni dhe caktimin e përfaqësuesve të tyre, janë marrë konfirmimet nga institucionet dhe është krijuar ekipi me 13 përfaqësues, si rrjedhojë i kërkohet Këshillit Bashkiak për miratimin e këtij këshilli vendor, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka diçka nga këshilltarët apo diskutime?

Këshilltar L.Petri: A është kjo një lëvizje paralele dhe udhëzim qeveritar që po bëhet për çdo bashki apo është diçka për Bashkinë tonë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Për të gjitha bashkitë. Atëherë nëse nuk ka diçka tjetër, e hedhim në votim kush është dakort?

**Hidhet në votim dhe miratohet**

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 22 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

**Pika 9 e rendit të ditës.**

**PËR NDRYSHIMIN E VKB NR. 42 DATË 27.05.2021 “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE ZHVILLUESIT PRIVAT SHOQËRIA BIGTAM SHPK PËR DHËNIEN E TRUALLIT PËR NDËRTIM, SIPAS PROCEDURËS TË PËRCAKTUAR NË VKB NR.33 DATË 25.03.2021” PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR NEGOCIMIN ME ZHVILLUESIT PRIVATË QË SHPREHIN INTERES TË BASHKËPUNOJNË ME BASHKINË KORÇË NËPËRMJET MARRËVESHJES PËR PRONAT NË PRONËSI TË SAJ”, NDRYSHUAR ME VKB NR. 31 DATË 29.02.2024.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni i ligjeve ju lutem.



Këshilltar K.Kocibelli: Në lidhje me këtë pikë ka të bëjë me një ndryshim që kërkohet por ky ndryshim vjen edhe pas dy ndryshimeve të mëparshme një të vitit 2021 dhe një të vitit 2024 ndërkohë që meqënëse është deh Anxhela mund të na i shpjegojë më mirë sepse me sa kuptoj unë ka të bëjë me një sipërfaqe e cila duhet paguar në lekë për shkak se nuk ka mundur ta japë në sipërfaqe të pasurive të paluajtshme.

Këshilltar D.Osmani: Znj.kryetare para se të kalojmë tek kjo pikë, kjo pika 7 kaloi apo jo?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ne u shprehëm sa vota janë.

Këshilltar D.Osmani: Kaloi apo jo?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mos bërtit, pse bërtet?

I llogarite ti, nuk tha njeri kaloi, ç'është kjo mënyrë komunikimi, sa u kënaqe.

Këshilltar D.Osmani: Po të isha kënaqur kisha dalë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ç'është kjo mënyrë komunikimi, më vjen keq.

Këshilltar D.Osmani: Pas çdo votimi deklarohet numri i votave pro, Eva më fal nuk e ke ti për detyrë të thuash kalon apo jo?

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Unë deklaroj thjesht numrin e votave.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ç'është ky komunikim kështu z.Osmani?

Këshilltar D.Osmani: Ta pyesim kush e ka për detyrë?

Pse po ofendoj dikë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ke një lloj mllefi të brendshëm, duhen 21 vota.

Këshilltar D.Osmani: Ta dimë e ne kaloi apo jo.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ti e di shumë mirë kur kalon.

Këshilltar D.Osmani: Nëse unë do doaj që materiali mos kalonte nuk do isha prezent këtu duhet të ishim 21 të bëhej kourumi këtë e dija, të dytën ndaj ta kërkova të ma thoshte kaloi apo jo, ku e shikon mllefin?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka mundësi të vazhdojmë me rendin e ditës, mos më ndërprit.

Këshilltar D.Osmani: Do ta prishim mbledhjen?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Çfarë kërkon?

Këshilltar D.Osmani: Unë po marr pjesë në mbledhjet e këshillit bashkë me kolegët.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E ke detyrim.

Këshilltar D.Osmani: Ashtu e kanë dhe ata tuajit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Merru me veten.

Këshilltar D.Osmani: Nuk merrem me të tjerët.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Unë të dija të mençur Devi.

Këshilltar D.Osmani: Nuk jam i mençuar, nuk e vendosni ju jam i mençur apo jo, e di atë fjalën nuk ka nevojë të jesh i mençur rëndësi ka të jesh i vojtur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ta ndërpresim mbledhjen?

Këshilltar D.Osmani: Mbledhjen jemi ne që nuk duam ta ndërpresim, prandaj po rrimë këtu që në 12 po jo të na gjykoni doja informacion.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të gjykova për mënyrën e komunikimit e ngrite zërin.

Këshilltar D.Osmani: Nuk jemi në kopësht.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Bashkia Korçë me sipërmarrësin e Shoqërisë Bigtam ka nënshkrua një marrëveshje në vitin 2021 të cilën më pas e kemi ndryshuar në 2024, në bazë të këtyre marrëveshjeve Bashkia vendos në dispozicion sipërmarrësit një sipërfaqe totale prej 776 m2 truall dhe në shkëmbim do marrë një sipërfaqe në masën 30% në objektin që do realizojë ky sipërmarrës tek sipërfaqja e Bashkisë por edhe tek sipërfaqja të tjera që i ka në pronësi e tij. Në bazë të kësaj marrëveshje sipërfaqja që ai do ndërtonte është 2298 m2 dhe sipërfaqja që i takon Bashkisë është 689 m2 pra 30% e sipërfaqes totale ndërtimore e ndarë në mënyrë të barabartë në gjithë katet ku në secilin kat na takon 76.6 m2 në total janë 536 m2 banimi 76.6 m2 njësi dhe 76.6 m2 bodrume kji ishte ajo që kishim parashikuar në marrëveshjet që përmenda, ndërkohë që ka erdhur një propozim nga sipërmarrësi që sipërfaqen e banimit ta japë tek objekti për të cilin ne i kemi dhënë dispozicion truallin ndërkohë që njësite dhe sipërfaqet e bodrumit të na i japë tek një objekt që ndodhet ngjitur me objektin ku ka marrë lejen e ndërtimit. Në këto kushte kemi ngritur një grup pune i përbërë nga punojës teknikë pra inxhinierë dhe topografe të cilët kanë verifikuar gjendjen faktike dhe kanë dalë me një propozim të cilin e keni në relacion të detajuar por po e them edhe unë tek godina ku kemi dhënë lejen e ndërtimit dhe do bëjmë dhe shkëmbimin me truallin propozohet të marrim 507 m2 banim ndërkohë që marrim njësi tek godina ngjitur 112 m2 dhe 76.69 m2 bodrum dhe këto tek godina ngjitur, mbetet një diferencë



prej 2.76 m2 që nuk e plotësojmë dot me sipërfaqe ndërtimore dhe do i marrim në vlerë lekësh në masën 113 mijë e 933 lekë total të 2 metrave, ky është propozimi që kemi sjellë, të detajuar ku janë njësitë e keni tek relacioni dhe tek hartat bashkëngjitur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar I.Bode: Me sa kuptova këto sipërfaqe janë të dhëna në lejën që është zhvilluar tashmë jo në një objekt të ri apo jo?

Nga pronat e Bashkisë janë dhënë zhvilluesit dhe kanë ndërtuar atje dhe po i marrim tani mbrapa?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Po.

Këshilltar I.Bode: Pse ka kaq pak sipërfaqe ndërtimi në sipërfaqe që ne kemi dhënë si pronarë, pse është 2298 m2 ndërtim mbi këtë sipërfaqe 766 që kemi dhënë ne?

Kjo sipërfaqje është e gjitha në funksion të projektit që është ndërtuar atje, është future si oborr të them mes atyre pallateve apo ku ta di unë?

Për çfarë i duhen Bashkisë garazhdi apo njësitë kur nevojat kuptohen janë më shumë për objekte banimi?

Këto njësi që po ofrohen janë pozicioni i përshtatshëm për tu quajtur tamam njësi apo ato që janë më të sakta janë rregulluar dhe këto kanë mbetur të fshehura nga mbrapa?

Përsa i përket kompensimit në lekë sipas çmimit të tregut që është sot në atë zonë ka më pronë që kushton 500 euro m2?

Për çfarë na duhen sipërfaqe nga 118 m2 e lart që shkojnë deri në apartamente me 155 m2?

Pse kjo marrëveshje nuk u bë që në fillim kur sot ligji dihet që pronari i truallit ka të drejtë zgjedhje në truallin që po jep për ndërtim dhe mund t'i zgjedhë sipërfaqet sipas interesit të vet në kubaturë apo m2?

Pse këto njësi apo bodrume të mos përfshiheshin në marrëveshje duke u konventuar në sipërfaqe banimi që gjykoj se është interesi jonë?

Këto kisha, flaeminderit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pyetjen 1 dhe 2 duhet ta sqarojë Arjola, për pikën 3 dhe 8, ai është dakort që të na i japë apartamente këto garazhde dhe njësi apo nuk e kemi negociuar?

Për pjesën urbanistike e sqaron Arjola në lidhje me marrëveshjen që mos kishim nga këto pretendime pse i more apartamentet në katin e 6 dhe 7 dhe nuk i more në katin 3, marrëveshja është specifikuar që marrin 30% të sipërfaqes ndërtimore në të gjitha katet që nga garaxhdi, njësi dhe katet me rradhë dhe kjo është pikërisht për të shmangur diskutimin e lagu nuk e lagu.

Këshilltar I.Bode: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e kisha me ty, mirë bërë që bërë pyetje por e them në përgjithësi, nuk ekemi diskutuar këtë pjesën e garazhdeve madje bie dakort që nuk na duhen fare besoj njësi dhe mund të na duhen por në rast se nevojat tona janë më shumë për apartamente mund t'ja paraqesim këtij zhvilluesit si opsion besoj se njësi mund të na duhen mund të jetë një qëndër komunitare, zyra e

bashkisë, ky shpjegimi për garazhdin dhe njësitë. Në lidhje me këtë të shkëmbimit, kërkesa ka erdhur nga zhvilluesit që njësite dhe garazhdet shikoni mundësitë mos i merrni tek ky objekt por tek objekti ngjitur, për mua si kryetar bashkie nuk ka rëndësi ku i marrim këto nuk e di për ju prandaj kemi ngritur grup pune. Përsa i takon kompensimit në lekë ta sqarojë Anxhela. Ato sipërfaqe që nuk i marrim dot në natyrë do i marrim në lekë, pyetja ishte pse kaq dhe jo aq për m2.

Këshilltar I.Bode: Pyetja ishte për vlerën, duke qënë se ne këtë vlerë po e marrim sot dhe jo në momentin kur është dhënë prona dhe që në 2021 deri sot çmimi i pronës ka pësuar një rritje të konsiderueshme, ju në relacion an thoni se ju jeni referuar kontratave të ngjashme që ndërtuesi ka bërë me klientët e vet dhe ka qënë diku për 500 m2, sot a gjen njeri një apartament që kushton kaq?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ta sqarojë Anxhela. Këto sipërfaqet me apartamente të mëdha besoj se mund t'ju gjendet përdorimi pasi nuk jemi të detyruar t'i përdorim për strehim social mund t'i kemi kemi për gjëra të tjera përshembull diçka që më vjen ndërmend mund t'i përdorim për sportistet e huaja që marrim dhe disa mund t'i akomodohen këtu, rëndësi ka t'i kemi këto asete nuk kemi diçka specifike.

Këshilltare A.Zheku: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk thashë 5 në një hyrje, por disa sportistë në një hyrje mund të rrinë. Këtë pronari mund ta zgjedhi sipërfaqen, nuk e di Anxhela çfarë është kjo?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk fiton më shumë si sipërfaqe aq do fitonte Bashkia, pra në m2 x tipologjia si është ndarë ky x varjon në rast se do kërkoje sipërfaqe më të vogla kjo varet në bazë të kërkesave. Tre pyetjet për Arjolën.

Ekzekutivi A.Çela: Quhem Arjola Çela jam inxhinierë gjeodete dhe vlerësuese e pasurive të paluajtshme, në pozicionin përgjegjës sektori pranë rregjistrimit të teritorit në drejtorinë e planifikimit, teritorit dhe zhvillimit të teritorit ne pasi kemi marrë dhe kemi shqyrtuar informacionin që subjekti ka paraqitur pranë Bashkisë Korçë ku ka dorëzuar sipërfaqen ndërtimore prej 30% të ndërtimit të përfutur nga shfrytëzimi i pasurive prone e Bashkisë Korçë tek pyetja e parë doja të sqaroja që sipërfaqja prej 776 m2 është e tëra në funksion të bllokut të banimit ndaj dhe kjo shoqëri ka bërë kërkesën për të marrë këto sipërfaqe një pjesë janë rrugë të brendshme, ka mbetur një pjesë për trotuare. Përsa i përket sipërfaqes totale ndërtimore është sipërfaqja e miratuar me leje ndërtimi 2298 m2 është sipërfaqe ndërtimore e marrë nga leja e ndërtimit kjo sipërfaqe që ka marrë zotëria.

Këshilltar I.Bode: Ndërtimi ka shkelur një pjesë të sipërfaqes 766 m?

Ekzekutivi A.Çela: Po sepse pjesën tjetër e kishte pronë të tij, subjekti ka bërë një plan të detajuar vendor ku përfshin një objekt i cili ka marrë lejen e ndërtimit, në funksion të këtij objekti kanë që rrugë të brendshme, trotuare sepse ka qënë bllok banimi dhe të arrihej ky projekt ishte e nevojshme të



merreshin dhe nevojshme të merreshin dhe këto sipërfaqe nga Bashkia Korçë që ishin pjesë e këtij studimi dhe kemi arritur në këtë marrëveshje sipërfaqjas që ne kemi nxjerrë e kemi nxjerrë me formule 30% është sipas ligjit, është detyrim ligjor. Sipërfaqja 2298 m<sup>2</sup> është sipërfaqja e marrë dhe e miratuar me leje ndërtimi pasi kemi llogaritur 30% e kemi shpërndarë nëpër kate. Për pjesën e pyetjeve nëse njësitë janë në pozicion të përshtatshëm, njësitë kanë dalje të menjëhershme në bllokumi i banimit, dy njësitë që zotëria ka paraqitur, vetrata kryesore ka një pozicionim të mirë sepse është nga veriu del direkt në bllok është e dukshme, ka ajrim, ndriçim të dyja njësitë, ato janë kufitare dhe janë në pozicion të favorshëm që Bashkia më tej do i përdorë. Pjesa e kompensimit në lekë pasi është bërë llogaritja në sipërfaqet që objekti na ka paraqitur, na ka mbetur një sipërfaqe prej 2.06 mos gaboj m<sup>2</sup> dhe ne kemi marrë çmimin nga tre kontrata që ai ka paraqitur, kontrata të apartamenteve në objektin ngjitur në të njëjtin bllok.

Këshilltar I.Bode: Më fal që po ju ndërpres këto kontrata që zotëria ka paraqitur, datojnë të themi dy-tre vjet?

Ekzekutivi A.Çela: Po po objekti është i ri, ne tentuam që të merrnim çmimin tek e njëjta vend ku morëm njësitë dhe garazhet që mos largpheshim dhe të treja kontratat janë marrë për apartamente jo për garazhe sepse dhe tek kontrata flasim për njësi ndërtimore dhe funksionale.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltare A.Përmeti: Kontratat janë në euro.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Ne mund të merrnim çmimin referues siç bëjmë llogaritjen e 3% që e llogaritim me 48 mijë e 300 lekë, ndërkohë që në këtë rast jemi referuar çmimit të tregut në atë zonë që është 50 mijë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar I.Bode: A mund të bëj një pyetje tjetër?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po patjetër, e fundit besoj.

Këshilltar I.Bode: Me sa po kuptoj se sot duhet të miratojmë propozimin që ka bërë ndërtuesi për të marrë atë 26% të mbetur të asaj që na takon tek objekti tjetër, gjithë të tjerat janë mbyllur, marrëveshja, për % e me rradhë?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar I.Bode: Ju po thoni që ai i ka ofruar, nuk i marrim dot gjë tjetër e po të duam t'ja ofrojmë sepse i ka shitur ai.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar I.Bode: Znj.Kryetare ju lutem, kur të vijë koha e diskutimeve me mirësjellje do ju kërkoja përsëri fjalën.

Këshilltare A.Zheku: A janë gjendje të pa shitura këto që ne na takojnë realisht, pra nuk i ka shitur subjekti.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje tjetër?

Këshilltar K.Pllaha: Në atë zonë ku është marrë leja, sa ka qënë koeficienti i indesitetit të ndërtimit?

Ekzekutivi A.Çela: Duhet ta shoh diku tek 1.6 por nuk jam e sigurt, ja ta shoh tek planifikimi.

Këshilltare A.Përmeti: Më fal pse na duhet ky informacion Klajdi që ta kuptojmë dhe ne.

Këshilltar K.Pllaha: Ideja është këtu që në varësi të koeficientit aq metra ndërtim mund të bësh në një sipërfaqe toke, nëse ne i kemi dhënë kompanisë 700 e ca metra katror e zemë shumëzohet me koeficientin dhe aq m<sup>2</sup> do ketë në të gjitha katet, sepse mua për një godinë 8-katëshe me një koeficient 3 më duket sikur nuk është e shfrytëzueshme në këtë mënyrë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e di pse po hyn në këto koncepte teknike urbane por të të sqaroj sepse mbase e di gabim, intesiteti i ndërtimit është totali i sipërfaqes të ndërtimit pjesuar me sipërfaqen e truallit, është një truall 1000m<sup>2</sup> është ndërtuar një gjë me 5 kate me bazën 500, 500shumëzim 8 4000, 4000 pjesim për 1000 4 është intesiteti.

Këshilltar K.Pllaha:Nuk e di mirë sepse nuk është mbi gjurmën por mbi pronën, merret mbi pronën total koeficienti.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Prona 1000 m<sup>2</sup> ndërtohet një objekt me gjurmë 500 m me lartësi 8 kate, sipërfaqe totale ndërtimore është 500 shumëzim 8, 4000 m<sup>2</sup>, 4000 pjesohet me pronën 1000 dhe del koeficientin 4.

Këshilltar K.Pllaha: Disa zona në qytet e kanë të përcaktuar koeficientin e indesitetit në bazë të tij bëhet ndërtimi dhe pyetja ime është pse në 700 m<sup>2</sup> që ne kemi vënë në dispozicion janë ndërtuar 2300, sa ka qënë koeficienti?



Kryetari i Bashkisë S.Filo: Indesiteti i ndërtimit maksimalisht në qytetin e Korçë është diku në 3, maksimalja, 3.6 ne 700 m<sup>2</sup> maksimumi që mund të ndërtosh është 2100.

Këshilltar K.Pllaha: Kjo sipërfaqe është ajo që është ndërtuar mbi tokën e Bashkisë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër ç'punë kemi me token e tij.

Këshilltar P.Tollkuci: Pyetja që bëri këshilltari Irvin ishte e drejtë, unë nuk kuptoba duke pyetur përsëri Arjolën që në këto 700 m që kemi dhënë nuk janë përdorur të gjitha për ndërtim por ka trotuare, e të tjera.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diskutime?

Këshilltar I.Bode: Jo pa qëllim unë pyeta nëse [rona që ne po japim është në qëllim të gjithë objektit apo jo, them të drejtën se jemi siç shkojnë punët sot me marrëveshjet midis pronarit dhe ndërtuesit, më duket se jemi shumë pronarë tolerantë sepse sip totale e atij ndërtimi nuk e di sa është mbase del nga këto mbledhjet e sip që na janë paraqitur k una takojnë nga 76 çdo kat, përderisa kjo pronë që ne po japim është në funksion të gjithë projektit edhe % që ne duhet të merrnim duhet të ishte sipas projektit, nëqoftse ne i kemi dhënë 766 m zotërisë ka ndërtuar apo nuk ka ndërtuar është punë e tij në totalin e vet që e ka shfrytëzuar për projektin e ka përdorur dhe kjo përbën x% të tokës që ai ka pasur gjithsej, në totalin e 20 e ca mijë mund të shkojë ndërtimi i gjithë nuk ka pronarë sot që të jep token e tij, në funksion të projektit tënd dhe t'i japësh 600 m, nuk ka pronar sot që t'i japësh 766 m dhe nga këto merr ndërtim 689 nuk ka unë e di sepse e njoh pak këtë fushë. Nuk kam asnjë problem me ndërtuesin ai është i lirë vetë të bëjë një marrëveshje si e ka ai të leverdishme pra nuk kam gjë me ndërtuesin nëse atë tokë do e kisha unë apo njëri nga ju dyshoj se do e jepte me atë marrëveshje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar I.Bode: Sipërfaqja totale e ndërtimit që është e shtrirë në x metra, sa nga kjo x metra e gjithë pronës përbën 766 metërshi im dhe mbi atë % do kërkoja atë që më takonte në totalin e ndërtimit pasi mendoj dalin më të leverdishme për ne.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar I.Bode: E kuptoj këtë që thonë por është e gjitha në funksion të projektit, mbase del e bëjmë bashkë. Ka ca gjëra teknike sepse duke qënë i fushës i disa gjëra, si do e bëja unë marrëveshjen për të qënë më e leverdishme, në momentin që bëj një marrëveshje me ndërtuesin i kërkoj që në fillim sesi e dua pjesën që më takon mua sepse jam pronari dhe kam të drejtë zgjedhje e kemi në ligj, përshembul i themi këto dyqanet nuk më inetresojnë por i dua të konvertuara në apartamente, bodrumet po ashtu me konvertimin në bazë të çmimit dhe porosia për apartamentet në bazë të kubaturës që mua më interesojnë më shumë deh katet nuk ka asgjë të keq sepse pronari zgjedh dhe katet flasim siç është tregu sot asgjë nga këto nuk ka ndodhur dhe nëse ka mundësi për tu ribërë si marrëveshje sepse ne fakt

më duket e kufizuar kjo mundësia për të bërë marrëveshje sepse një pjesë të apartamenteve zotëria i ka shitur dhe ato ç'kanë mbetur po i marrim ne se nuk kemi ç'bëjmë tjetër, këto kisha.

Ekzekutivi A.Çela: Nëse do niseshim nga konstatimi që ju thatë sa është % e truallit tonë që është në pronësi të Bashkisë nëse do niseshim nga kjo unë sqaroja dhe pak më parë që kjo pjesë e sipërfaqes 766 nuk është vetëm ndërtim por edhe trotuare dhe pjesë të brendshme.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani Irvin mënyra sesi është bërë llogaritja është bërë fiks siç e thua ti, pra është bërë duke marrë propocionin e truallit që ka Bashkia në raport me totalin e kundërta do ishte gabim qoftë në favor qoftë në disfavor të Bashkisë. Në favor do ishte nëse gjithë apartamenti po të ishte një sip më e madhe se 700 m2 do binte gjitha në pronën tonë se mund të ishte dhe ky skenar në disfavor do ishte nëse në gjithë zhvillimin këtu do ishte vetëm një cep i pallatit na jepnin 700 m dhe llogaritjen e bënim vetëm mbi cepin që ishte ndërtuar mbi pronën tonë dhe kjo do ishte disfavor ajo që është bërë është bërë fiks. Kjo është llogaria tani mendoje njëherë me gjakftohtësi me aritmetikë, këtu jemi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 18

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 21 këshilltarë, 18 pro, 2 kundër, 1 abstenim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E keqja është se je dhe vetë ndërtues dhe po të vije tek Bashkia nuk e dije se çfarë do kërkoje.

Këshilltar I.Bode: Po flas si pronar trualli.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ne kemi bërë fiks atë që sygjerove dhe tani e voton kundër.

Këshilltar I.Bode: Nuk e keni bërë se ju nuk më dëgjuar morët telefonatën dhe dolët jashtë, nëse do më pyesni si ndërtues unë ku ta gjej një pronar si ju.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kemi bërë fiks atë që sapo përshkruat.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Tani e votuam, nuk ka kuptim të diskutojmë, u miratua e theksova Devi që mos kemi më përplasje.

**Pika 10 e rendit të ditës.**

**PËR NDRYSHIMIN E LLOJIT TË TRANSFERIMIT TË TOKAVE QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA**



PRODUKTIVE) ME NR PASURIE NR.420, NR.421 ZONË KADASTRALE 1631 ME VENDNDODHJE NË FLOQ, PASURIA NR.772, NR.774, NR.768, NR.766, NR.777 ZONË KADASTRALE 2063, ME VENDNDODHJE NË KAMENICË, NJA MOLLAJ DHE PASURITË ME NR 584/7, NR.584/8 ZONË KADASTRALE 1472 ME VENDNDODHJE NË DËRSNIK, NJA VOSKOP, NGA PËRDORIMI NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË SIPAS GENPLANIT BASHKANGJITUR”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë komisioni i ligjeve ju lutem, Kristi nuk qenka Anxhela të lutem.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Sikurse jeni në dijeni Bashkive ju janë tranfesuar një sërë pronash në tërësi dhe në përdorim, në rastin konkret bëhet fjalë për disa toka buqësore që janë transferuar në pronësi të bashkisë bëhet fjalë për toka buqësore në Floq, Kamenicë dhe Drësnik ne jemi në një process përmirësimi dhe përditësimi të listave të investtarit ku po bëjmë të mundur indetifikimin e gjitha pronave po përcaktojmë sipërfaqen e saktë dhe njëkohësisht dhe kufitë por në rastin konkret përveç këtyre të treja po kërkojmë dhe ndryshimin e llojit të transferimit, tokat buqësore na kanë kaluar në transferim ne po i kërkojmë që të na transferohen në pronësi. Ky është hapi i parë më pas bëjmë planin e rivlimit e çojmë në dretjorinë qëndrore të ASHK dhe më pas del dhe vendimi i Këshillit të Ministrave dhe pastaj bëhet dhe rregjistrimi në emër të Bashkisë, kjo është ajo që po kërkojmë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se komenti i Anxhelës ishte i plotë, ka pyetje?

Këshilltar K.Pllaha: Dy pyetje të vogla, e para lexoj tek ky materiali në kuadër të investimeve që Bashkia Korçë ka për qëllim të realizojë në këto pasuri. Ka ndonjë plan se çfarë investimesh do realizohen tek kjo pasuri?

E dyta a i prek qiramarrësit e këtyre tokave, një pjesë e tokave në pronësi të Bashkisë janë dhënë me qira me afate të ndryshme , a i cënon ky tjetërsimi i pronësisë?

Bashkia bën shumë mirë që të marrë pronësinë e tokave të saj por a vlen e njëjta gjë edhe për banorët, a janë pajisur ata me çertifikata pronësie, a është bërë studimi i gjithë zonës?

Këshilltare M.Like: Doja të dija ku ndodhen këto në Kamenicë dhe në Floq si pasuri dhe janë përdorur nga ndonjë palë tjetër këto apo kanë qënë gjithmonë të lira?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje tjetër?

Këshilltar L.Petri: Më shumë e kam proceduriale nëse i shihni të udhës që t'i miratojmë veçe veçe sepse e kuptoj që kanë një ngjashmëri në koncept por ndoshta kanë dhe veçantira dhe do ishte e udhës të votoheshin më vetë, pse janë të gjitha së bashku sepse sit ë themi po ne si i njomuri si i laguri futen në një.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje tjetër?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe njëherë që ta kuptojmë ç'po kërkojmë, po kërkojmë që këto dy pasuri nga pronë shtet të kalojnë në pronësi të Bashkisë pra janë pronësi shtet dhe t'i kalojmë në pronësi të Bashkisë. E dyta nuk kemi dhënë kontrata në këto prona, nga sa kemi informacion nuk dimë të jenë të përdorura aktualisht dhe historikisht. Vendndodhja sipas hartës respective i keni shikojeni, përse i takon rregjistrimit të pronave të fermerëve në fshatrat Kamenicë dhe Floq në dijeninë time ai procesi ka përfunduar, nuk kanë probleme nuk është e lidhur me këtë tonën.

Këshilltar D.Osmani: Këto janë toka buqësore që mund të përdoren nga fermerët apo productive?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është thënë produktive.

Këshilltar D.Osmani: Meqënëse jemi në kuadrin e tokave mund të na jepni ndonjë informacion në lidhje me problematikën që kanë dy fshatrat Dërsnik dhe Dvoran deri ku është si procedure, jemi jashtë kësaj por nëse ka ndonjë të re?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk ka asnjë zhvillim përse i takon asaj mbivendosjes që ka midis kufirit të Dvoranit dhe Kamenicës.

Këshilltar K.Pllaha: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po kërkojmë t'i marrim në pronësi të Bashkisë në varësi të nevojave tona dhe projekteve tona t'i vemë në eficiencë, e rëndësishme është që t'i vemë të përdoren për diçka sepse aktualisht nuk përdoren për asgjë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E hedhim në votim, kush është dakort/

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 22 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

**Pika `11 e rendit të ditës.**

**“SIPAS KËRKESËS TË SHOQËRISË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:**

**PËR NDRYSHIMIN E STATUTIT DHE SHTIMIN E OBJEKTIT TË VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A.**



Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar K.Kocibelli: Ka erdhur një kërkesë fillimisht nga Qendra Sportive Korçë Sh.a për thirrjen e Asamblesë të Përgjithshme për shqyrtimin e materialit dhe një ndër pikat e tyre është dhe ndryshimi i statutit dhe shtimi i objektit të veprimtarisë, si rrjedhojë kërkohet të ndryshohet statute dhe ti shtohet objektit të veprimtarisë të kësaj shoqërie adminstrimi i Qendrës Rinore i cili kërkohet që të ketë 3 punojës në veprimtarinë e saj, pra kërkohet fillimisht të miratohet statuti pastaj pika tjetër.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka?

Këshilltare A.Përmeti: Në rastin e ndryshimit të veprimtarisë të një sha-je, nuk e kuptoj pse duhet të jetë me ndryshim statute kur vperimtaria është rinore, sportive sepse ishte shumë e gjërë dhe pse duhet të ndryshojë statuti sepse janë sis h.a e tjera dhe ato nuk ndryshojnë statutin e bëjnë me vendim asambleje?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje tjetër?

Këshilltare A.Zheku: Unë vlerësoj vëmendjen ndaj rinisë dhe t'i bashkëngjitet qendrës të fëmijëve por a kemi një plan konkret të aktivitetit të këtij personeli, pyetja ime ishte dhe para se të fillonte seanca dhe u tha që do të fillonte fillimisht 1 person dhe më pas dy të tjerët, por efekt fiannciare fillojnë nga momenti i miratimit edhe do parashikohet buxheti për paga për këta tre persona dhe do të fillojë vetëm njëri pra janë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal që po të ndërpres por nuk janë në kundërshtim, janë në funksion të mënyrës pasi ne nuk i marrim direkt njerëzit pa i zënë me punë, fillimisht do marrim 1 duke u shtruar aktiviteti do shohim dhe të tjerë.

Këshilltare A.Zheku: Keni një plan apo draft të aktivitetit që ata do zhvillojnë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kemi një draft që të aktiviteteve që do zhvillohen atje por jam i hapur të dëgjoj dhe sygjerimet tuaja dhe jo vetëm mund të shtohen aktivitetine qëndres.

Këshilltare A.Zheku: Mund të kemi një informacion të aktiviteteve?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ti jap fjalën Joanit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Para se t'ja japim fjalën Joanit ka këshilltarë të tjerë që duan informacion?

Këshilltar K.Pllaha: Ndryshimet statutore të një SHA-je mos kërkojnë 2/3 e Asamblesë sepse nëse është kështu ne nuk i kemi.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Kërkojnë2/3 e aksionerëve ata vendosin për ndryshimin e statutit.

Këshilltar L.Petri: Mbaj mend që në disa mbledhje të mëparshme z.kryetar ka përmendur që nuk ekishin vendosur nëse Qendra Rinore do varej nga Bashkia, nga Ministria apo nëse do ishte sipërmarrje private

apo shoqate që do e menaxhonte, dua ta di nëse ne tani do e marrim të mirëqënë që varet nga Bashkia, se mua si qytetar më duhet dhe kush do i kërkojë llogari kujt atje për mbarëvajtjen e gjëse?

Pra në finale si do bëhet administrimi dhe pyetja e dytë, pagat e cilësuar këtu janë bruto apo neto?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për kryetarin, ka pyetje të tjera pastaj diskutime. Devi ke pyetje?

Këshilltar D.Osmani: Në lidhje me numrin e punojësve që aktualisht ka qendra në totalin e saj, nuk e kam, nuk e mbaj mend sa është meqënëse po kërkojmë shtesë të bëjmë dhe një përlogartije sa ka aktualisht qendra dhe kaq e nevojshme është të shtohen dhe tret e tjerë kur edhe në pikat e mëparshëm u diskutua puna e pjesës të shtimit apo tepricës të punojësve të bashkisë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani sepse e kam përsëritur shumë herë nëse unë do kisha një sjellje të pa përgjegjshme institucionale në lidhje me punësimet do i kisha rënë me top edhe këtu do e bëja strukturën me 3 dhe nuk do merrja një në fillim, tani i vëmë kapak kësaj historie sepse e kemi diskutuar nga 100 herë. Nuk ka kapacitete të lira tek kjo qendër në lidhje me aktivitetet që ajo bën. Përsa i takon varësisë nuk kam thënë ndonjëherë që do varet nga Ministria apo biznes privat por meqënëse është një funksion implementues nuk mund të jetë pjesë e Bashkisë si institucion por e njërës nga institucionet e varësisë gjithnjë me sensin për të kursyer që mos bëjmë një institucion të ri varësie me shef finance me historira për të menaxhuar qendrën rinore kemi emnduar që dhe me natyrën e aktivitetit dhe me grupmoshën që i ofron shërbim afron me aktivitetin e Qendrës Sportive dhe rëndaj do të jetë një strukturë brenda qendrës që do bëjë menaxhimin e Qendrës Rinore.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush e do fjalën për diskutime?

Këshilltar D.Osmani: Me sa u informova Qendra Rinore është atje tek seli e ps kati i 1 dhe 2 që do ketë diskutime do ketë, unë e thashë që në fillim që kjo bashki ka më shumë sesa duhet njerëz të cilët nuk i fut në punë t'i shtosh edhe 3 të tjerë patjetër kemi kundërshtimet tona. Kjo Qendra Rinore që është atje dhe ju doni të punësoni dhe 3 veta të tjera gjatë këtyre viteve nuk ka qënë ndonjë institucion që ka shërbyer thejst ka qënë një hyrje për të rinjtë tuaj jo të qytetit, nëse ju doni ta transaformoni dhe të thoni se është Qendra Rinore e qytetit kjo është pjesa juaj por të na kërkon të punësojmë dhe tre veta atje se nuk ju dalin ju llogaritë për Partinë Socialiste nuk jam dakort.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani Partinë Socialiste kot e ngatërove sepse po flasim në pozicionin unë si kryetra ju si këshilltar bashkie por po të pyes sepse nuk ke pyetur sepse këtë e the në kuadër plotik por ka prindër demokratë që fëmijët e tyre kanë frekuentuar këtë qendër dhe mirë kanë bërë i inkurajoj ta frekuentojnë akoma më shumë siç kanë frekuentuar dhe projekte të tjera të Bashkisë që shqyr janë dhe duhen frekuentuar me focus të rinjtë që unë nuk i shoh as të kuq as blu.

Këshilltar I.Bode: Më shumë si procedurë znj.kryetare unë mendoj se kjo pikë duhet bërë me votim të ndarë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër.

Këshilltare A.Zheku: Duam përgjigje znj.kryetare.



Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem si nuk e kërkoj fjalën sepse i konsumoi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Janë 26 në plan thotë Anxhela dhe 24 në fakt po përtej numrit se numri nuk thotë asgjë është një shifër. Pyetje do ishte çfarë bën gjithsecili prej tyre?

Këshilltar D.Osmani: I dimë të gjithë çfarë bëjmë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk kam bërë ndonjer inventarin e qendrës se është ulje.

Këshilltar D.Osmani: Tani ajo qendra e qytetit hajde bëjmë debat frekuentohet apo jo.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani stafi i Qendrës Sportive ishte 26 me 24 dhe pasi ta thashë këtë të thashë duhet të pyesësh se çfarë bëjnë.

Këshilltar D.Osmani: Nuk kam gjë me Qendrën Sportive, po them për Qendrën Rinore që e ke poshtë selisë tënde.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po pyete për sfatin dhe në të njëjtën godinë me Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Këshilltar D.Osmani: Tani jemi shumë të ndërgjegjshëm që në kohë fushate përveç të rinjve tuaj nuk ka të rinj të tjerë kot.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kështu thatë edhe për Rin Showun por ishte gjithëpërfshirës.

Këshilltare A.Zheku: Z.Kryetar tha që për përgjigjen tuaj do i jap fjalën z.Joan në lidhje me planifikimin, planin, projekt.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Unë ju thashë kryetari e përmendi vetë, po të doni e dëgjojmë edhe njëherë nga kryetari.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Qendra do jetë në funksion të të rinjve të qytetit dhe antyra e shërbimeve që do ofrohen atje , mendimi im dhe sygjërimi im për ata që do merren do jetë që të jetë komplementare me shërbimet e tjera rinore që ofrojmë tek Qendra e Artit dhe Kulturës apo biblioteka, kryesisht do jenë të spektrit të argëtimit dhe të kalimit të kohës të lirë.

Këshilltare A.Zheku: Kur vjen një propozim gjithëkujt i kërkohet një draft të gjithë aktivitetit, nuk e shoh as në material as nga ana juaj.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Çfarë propozim po ju vjen ju sot?

Këshilltare A.Zheku: Të shtohen 3 persona për të bashkëlidhur këtë Qendrën Rinore.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po them që në parim kjo është diçka që plotësohet, e thashë 10 herë deri tani ta them dhe për herën e 11 nuk do marrim 3 persona në strukturë do parashikojmë 3 por fillimisht do marrim 1, nuk duhet 1 persona the të hapë të mbyllë derën?

Informacion më të gjërë do ja u japim herën tjetër pasi të ketë filluar, por kryesisht do jenë të spektrit të gjithëpërfshirjes, të argëtimit.

Këshilltar L.Petri: Unë në parim e mbështes këtë nismë madje është e vonuar që të ketë një Qëndër Rinore dhe për kreshëri të kolegëve dua të ndaj përvojën time, ka qënë viti 2014 kur ishte bërë dhe ndryshimi në nivel qeveritar dhe mua më është ofruar një vend pune atje për të qënë menaxher nga ish-këshilltari i zv.kryeministrit asaj kohe dhe i kam thënë të njëjtën gjë sepse për hir të së vërtetës unë me shokun time bëmë shumë përpjekje për të ndërtuar një Qëndër Rinore por dështoi për arsyt e veta dhe kur mu ofrua ky vend kam thënë do vi nëse në kohë fushate nuk do vini me flamuj partie atje me idenë që të bëhet diçka e lirë dhe më thanë jo më vjen keq sepse kjo qeveri po e çel këtë qëndër. Po e parashtoj këtë gjë sepse z.Osmani ja kaluat me të qeshur që ç'i keni këto sepse atje është Partia Socialiste, mëndësia në vendin ku jetojmë është kjo dhe uroj që të ketë ndryshuar, të merren njerëz që të kenë atë lirinë e merituar për të organizuar të rinjte pa ndikimin e strukturave dhe të bëhen procedurat e qarta sesi përzgjidhen.

Këshilltare A.Zheku: Përveç fondit të pagave të miratuara ato aktivitete që do duhen të zhvillohen do duan dhe një buxhet unë i mbështes pafund këto iniciativa, ne nuk i kemi përfshirë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Sapo më konfirmojë gjënë që do bëjmë, ti më kërkove llogari çfarë do bëjmë në detaje sikur unë po të sjell buxhetin e qëndrës dhe ti më pyet se çfarë do bësh ndërkohë që jemi në A-ja ti me pyet për y-në, ne po themi se ku do e vendosim si strukturë do e bëjmë institucion më vete dhe unë them se më efiçiente është kjo ku e kemi vendour.

Këshilltar I.Bode: Për kryetarin ekisha pyetjen, pasi shoh që po e bezdisim kur i them pse të duhen njerëz akoma, unë duhet të mendoj që pasi t'ja kem miratuar strukturën dhe vendet e lira duhet të bazohem vetëm tek përgjegjshmëria e tij për të mos i mbushur këto vende me njerëz sepse nuk është se nuk ka ndodhur që gjatë fushatës kanë ndodhur punësimet sepse kanë ndodhur pa po themi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mos kanë ndodhur kohë më parë?

Këshilltar I.Bode: Pak rëndësi ka kur, për kohët më parë ata që e kanë bërë e kanë marrë ndëshkimin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Dhe këta do e marrin.

Këshilltar I.Bode: Tani do diskutojmë si janë bërë votimet?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Dhe si janë bërë.

Këshilltar I.Bode: Dhe çfare reputacion keni ju në njerëzit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Reputacionin e tregon vota.

Këshilltar I.Bode: Vota jo patronazhimi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kalojmë në votim, kush është dakort, brenda pikës 11 ka një pikë e hedhim në votim?

Hidhet në votim dhe miratohet



Vota PRO 21

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 21 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

- PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË STRUKTURËN E PUNOJËSVE TË SHOQËRISË "QËNDRA SPORTIVE KORÇË"SH.A

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 19

Vota KUNDËR 3

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 19 pro, 3 kundër, 0 abstenim.

**Pika `12 e rendit të ditës.**

**"SIPAS KËRKESËS TË SHOQËRISË "TREGU I SHITJES FRUTA-PERIME" PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:**

- Pasqyrat fiannciare për treguesit e vitit 2024.
- Raport auditimi i audtiuesve ligjore për vitin 2024.
- Plan biznesi për vitin 2025.
- Porpozim për emërim të audituesve ligjorë të miratuat për vitin 2025.
- Shpërndarjen e fitmit të vitit 2024 i cili do kalojë për investime.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kalojmë në pikën a ka diçka nga këshilltarët?

Këshillatë A.Zheku: Po lë mënjanë pjesën e dorëzimit por një sy që u hodha pak shpejt e shpejt sepse në email nuk i kisha parë ka një mos përputhje dhe kam pyetje për financierin apo kontabilisten, në një deklaratë të thënë nga ju thuhet se shoqëria ka hartuar pasqyrat finaciare të vitit 2024 komfort standarteve kombëtare të kontabilitetit, ndërkohë që referuar raportit të audtimit të pasqyrave finaciare të të njëjtit vit thuhet se pasqyrat fiannciare janë hartuar në përputhje me standartet kombëtare të raportimit financiar, si dhe përgjegjësite e personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare paragrafi i fundit thuhet drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e duhur të pasqyrave financiare në përputhje me snrf, pyetja ime është pasqyrat financiare të kësaj shoqërie paraqiten sipas skk apo sipas snrf pra është gabim fianncierira sepse e shprehur dhe në bazë ligjore këtu citohet dhe baza ligjore dhe tek pasqyra e shpenzimeve që pashë të 2024 një nga zërat ishte shpenzimi për ekspert kontabël, term i cili duhet hequr vëretje për financierin sepse prej shumë vitesh është zvëndësuar auditees ligjor dhe i japim pagesën 1 milion e 800 mijë të vjetra audituesit ligjor dhe financiera që është po e fushës përdor termin ekspert kontabël, jemi në kushtet ku kemi hartuar

pasqyrat financiare të publikueshme të kësaj shoqërie komfort sstandarteve kombëtare të kontabilitetit apo është detyrim ligjor që duhen zbatuar standartet ndërkombëtare të kontabilitetit sepse jemi para faktit që ne duhet ti miratojmë këto pasqyra sipas shk apo sipas snrf dhe ato nuk janë zbatuar?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju kishit dhe koment dhe pyetje.

Këshillatë A.Zheku: Unë nuk thashë propozim unë pyeta.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Shikojeni dhe kontekstin e të gjithës të 5 pikave.

Këshilltar D.Osmani: Në lidhje me bilancin vë re se ka rritje të të ardhurave për vitin 2024 ndërkohë që fitimi është përgjysmuar, rritja e vetme është rritja në paga dhe shpenzime nga 10 milion në 12. Tek shënimet shpjeguese kemi një zë banka depozita 10 milion e 700 mijë, një sqarim sepse nuk di ta lexoj këtë pikë. Shikoj në pjesën e shpenzimeve të pagave përveç pagave të personelit, pagave të këshillit mbikëqyrës kemi dhe shpenzime për punojësit për çfarë janë këto shpërblime dhe si i keni vlerësuar, këto kam.

Këshilltarë A.Përmeti: Nuk kam pyetje e kam diskutim, bilanci është hartuar në bazë të standartit kombëtar të kontabilitetit por audituesit e kanë audituar bazuar në standartet ndërkombëtare të auditimit që njihen nga ana e auditimit.

Unë nuk të ndërpreva Alketa po shpreh mendimin tim, mere fjalën dhe shprehe. Në pjesën e pasqyrave financiare e kemi diskutuar dhe vitet e tjera sh.a nuk kanë shpërblime për punojësit por vetëm për këshillin mbikëqyrës në mbledhjet që reagojnë.

Këshilltar D.Osmani: Unë po e lexoj Ada.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Një moment ta marr fjalën unë ta jap ty.

Këshilltar D.Osmani: Unë jam i destinuar të rri në bankë, Ada e gjeti zgjidhjen shpejt.

Këshilltarë A.Përmeti: Nuk kam asgjë me këshilltarët shpreha mendimin tim.

Këshilltar D.Osmani: Shpreve atë që thashë unë.

Këshilltarë A.Zheku: Kam një koment audituesit bazohen tek standarti kombëtar i auditimit dhe nuk është një nivel më lart se shk sepse janë dy gjëra që nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën. Standartet e kontabilitetit janë baza e hartimit të pasqyrave financiare të publikueshme ndërsa paragrafi që audituesit kanë shkruar në raport janë që pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me snrf, pra nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën dhe pasqyrat financiare hartohen ose referuar shk ose referuar snrf dhe një kategori e caktuar njësish kanë detyrim ligjor për të hartuar pasqyrat financiare sipas snrf dhe një kategori tjetër sipas shk.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga drejtori në lidhje me pyetjet e këshilltarëve?

Ekzekutivi A.Zguri: Është kjo puna e depozitës 10 mijë e 700 lekë.



Këshilltar D.Osmani: Pse ka përgjysmim fitimi ishte e para kur janë rritur të ardhurat.

Ekzekutivi A.Zguri: Sepse u rriten pagat, po të shohësh shpenzimet janë të njëjta nuk ka rritje, po të shohësh shpenzimet e vitit 2025 janë të njëjta me 2024, në lidhje me shpërblimin janë në kontratën e çdo punojësi për mbylljen e vitit në rast se tregu del me fitim jepet paga e 13, shpërblimi është i përcaktuar dhe tek plani i biznesit si shpërblim punojësit e kemi të përcaktuar nëse realizohet plani jepet paga e 13.

Këshilltar D.Osmani: Dëgjova nga kolegët që nuk lejohen shpërblime.

Këshilltare A.Përmeti: Kështu na është thënë.

Ekzekutivi A.Zguri: Kjo depozita 10 mijë e 700 lekë është depozita e tregut e akumuluar gjithë këto vite, është vendosur një depozitë bankare e mbyllur në bankë me % 5-vjeçare për të marrë % fitimit dhe për të rritur depozitën.

Këshilltar D.Osmani: Është depozitë me interes?

Ekzekutivi A.Zguri: Po.

Këshilltar D.Osmani: Këto të ardhurat e tjera janë të ardhurat nga interesat?

Ekzekutivi A.Zguri: Jo, janë nga tregu, në planin e biznesit i ke të përcaktuara këtu poshtë janë 365 mijë e 160 lekë për vitin 2025.

Këshilltar D.Osmani: Këto duhet të ishin në zë më vete sepse janë të ardhurat nga interesat jo nga aktiviteti, apo e kam gabim Vasil?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po bëhet sikur keni ardhur në kafene dhe po diskutoni.

Këshilltar D.Osmani: Nuk e ke të reflektuar në bilanc, po sqarojmë pasqyrat dhe po të ketë ndonjë gabim ta korrigjojmë. Klientët furnitorë çfarë janë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ja kishim dhënë fjalën drejtorit, të mbarojë ai ç'ka për të thënë dhe nëse ka mbaruar të ketë tjetër sygjërim.

Këshilltar D.Osmani: Klientët furnitorë çfarë janë?

Ekzekutivi A.Zguri: Të ardhurat e tregut dihet që janë të ardhura nga dhëniet me qira të ambienteve, magazinat, qiran nga zyrat, nga vendparkimet, nga biletat e tregut, nga shërbimet e tretë që nuk varet nga ne por nga konsumi i bizneseve.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Këtu në sallë është dhe eksperti që mund të shtojë diçka dhe këshilltarët mos vazhdojnë të bëjnë pyetje, komente por sqarohen dhe nga ju.

Eksperti V.Xega: (Nuk ka audio.)

Këshilltar L.Petri: Kisha një pyetje për drejtorin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Për ekspertin.

Këshilltar L.Petri: Për ekspertin unë nuk jam i fushës dhe e marr të mirëqënë atë që thotë sepse e vlerësoj për kontributin.

Këshilltar L.Petri: Tregu i shumicës është bërë objekt bisede këtu në Këshill për mënyrën e menaxhimit, kenë reflektuar ju si bord i shoqatës apo menaxherët tuaj, për qasjen menaxheriale, ka ndonjë ndryshim që të jetë treg shumicë dhe jo unë si konsumator familjar që nuk kam as pikë shitje vi atje ble dhe ik, faleminderit.

Ekzekutivi A.Zguri: Meqënëse fermerët vetë nuk kanë një treg të tyre për të tregëtuar mallrat, ne kemi vendosur t'ju ofrojmë vendet tek tregu brenda, në momentin që fermerët futen atje ne e shohim gjithë mallin e tyre e kanë problem ta shesin me shumicë, prandaj kemi toleruar pak lënien e njerëzve më shumë për të blerë mallrat e fermerëve, nëse ju si Këshill Bashkiak vendosni t'i ndaloni njerëzit të vijnë të blenë sepse nga njëra anë e ngremë me të madhe malli i fermerëve të shitet ose t'i lemë t'i shesin në këtë mënyrë, ne kemi marrë masa nuk e kemi lënë fare kështu por është pak e vështirë për t'i ndalaur njerëzit të futen në treg brenda pasi ka atë problemin që është ngjitur me qytetin dhe nuk mund t'i ndalosh njerëzit sepse dyert janë hapur hyjne makinat, këtë problematikë e krijon distanca e afërt me qytetin sepse po të ishte larg nuk do vinin në këmbë. Para 2-3 vitesh mbyllëm dyert për të shmangur futjen e njerëzve dhe u bë pak problematike erdhën mediat, u ngritën dhe njerëzit, fermerët pse u mbyllën dyert dhe kjo ndodh sepse tregu është afër me qytetin, nuk i ndalon dot njerëzit shtojmë fuqinë punëtore sepse ata punojnë që kam nuk arrijnë dot t'i ndalojnë, nuk ka më të vijë importi sim ë parë pjesa e madhe është prodhim vendas.

Këshilltar E.Fejzulla: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mos e bëjmë si bisedë.

Ekzekutivi A.Zguri: Vjen fermeri si mos e futim fermerin brenda?

Këshilltar E.Fejzulla: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.)

Ekzekutivi A.Zguri: I bie t'i lemë fermerët të shesin jashtë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mos e bëjmë si bisedë dyshe z.Fejzulla, i hedhim në votim pikat me radhë.

- Pasqyrat fiannciare për treguesit e vitit 2024.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 18

Vota KUNDËR 3

Vota ABSTENIM 1



Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 18 pro, 3 kundër, 1 abstenim.

- Raport auditimi i audiuesve ligjore për vitin 2024.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 20

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 21 këshilltarë, 20 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

- Plan biznesi për vitin 2025.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 17

Vota KUNDËR 3

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 21 këshilltarë, 17 pro, 3 kundër, 1 abstenim.

- Porpozim për emërim të audituesve ligjorë të miratuar për vitin 2025.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Tollkuci kë propozoni?

Këshilltar P.Tpllkuci: Popozoj të jenë të njejtë z.Vasil Xega dhe znj.Ilda Ikonomi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka porpozim tjetër, nëse jo i hedhim në votim, z.Vasil Xega?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 21 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Ilda Ikonomi

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 21 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

- Shpërndarjen e fitimit të vitit 2024 i cili do kalojë për investime.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 21 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pikat e tjera janë informacione, njëri mbi projektin Qendra ditore për Fëmijë vëzhgim i bërë nga aleanca e grave këshilltare dhe e dyta informacioni mbi barometrin gjinor për vitin 2024 materialet janë shpërndarë. Ka në pikat endryshme një qytetare që ka që në fillim të takimit, para se t'ja jap fjalën po ja jap fjalën Edës e cila është njohur me problematikën.

Këshilltare E.Mitre: Ne jemi të gjithë të ndjeshëm ndaj problematikës të znj.Rabian dhe jemi njohur disa herë, ajo kërkon thjesht një ndërim të hyrjes me disa banorë që ajo pretendon që nuk jetojnë, ka bërë biseda edhe me drejtorinë e strehimit dhe me kryetarin dhe kryetari i ka dhënë një fije shprese se nëse ata nuk banojnë atje ne nuk e kemi të vë atje ne nuk e kemi të vështirë për të bërë ndryshimin. Unë ju propozoj ju edhe në emër të komisionit të mirëqënies sociale të ngremë një komision të vijë kush të dojë të shkojmë 2-3-4 herë pa lajmëruar derisa të dalim në një përfundim. Ne kemi shkuar vjet ata ishin por Rabiani pretendon se ata janë lajmëruar, të shkojmë në momente të ndryshme të ditës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se je dakort me vendimin e komisionit dhe e ke kuptuar se ne jemi këtu për të të ndihmuar.

Qytetaria: E kam pritur komisionin në shkurt dhe nuk ka erdhur, kam lënë një letër (nuk ka audio.)

Këshilltare E.Mitre: Nuk do lodhemi, do vijmë disa herë ta japim fjalën për këtë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Duke ju falenderuar për këtë mbledhje të stërgjatë, dhe kush do shkojë me pushime ju uroj pushime të mbara!

Dhe mundohuni mos mungoni në mbledhjet e këshillit, llogaritini mirë pushimet.

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI

